38 rue Raulin 69007 T 2 Centre Berthelot
T 1 Quai Claude Bernard

I mbyllur më 5 tetor dhe më 23–24 nëntor.

GH - LES PORTES DU SUD

Vetëm me takim :

→ **Sekretaria:** 04 72 89 86 03
të hënën, të martën dhe të enjten: 9:00–16:00

→ **Shërbimi social:** 04 27 85 21 56
nga e hëna në të enjten: 9:00–16:00

→ **Infermiere:** të hënën, të martën: 9-16:00
të mërkurën: 9:00–12:00 04 72 89 88 95
2 Avenue du 11 novembre 1918
T 4 Spitali Feyzin Vénissieux

Shoqatat mjekësore

MÉDECINS DU MONDE: LE CASO

Konsulta mjekësore falas për personat pa sigurim shëndetësor. Mjekë, punonjës socialë, parandalim.
Të hënën në orën 08:30 Të mërkurën në orën 13:30 (ejani pak para hapjes)
103 cours Gambetta 69003
M D Garibaldi T 4 Manufacture-Montluc

→ **Ju lutem telefononi para se të vini; mesazhi i postës zanore është i përditësuar:**
04 72 92 49 01

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

MÉDECINS DU MONDE: LE BUS

Shërbim dëgjimi, parandalimi dhe shëndeti. Për të gjithë.
Një të martë në dy, si edhe çdo të enjte, ora 19:00–22:00.
Place Carnot 69002 M A Perrache
Një të martë në dy, ora 19:30–21:30 (me Camions du Cœur).
172b Rue Anatole Francë M A Flachet

ESSIP - KUJDES INFERMIEROR

Ekip lëvizës i kujdesit infermieror. Shoqërim në rrugëtimin shëndetësor dhe për aksesin në të drejtat shëndetësore. Me recetë mjekësore për kujdes infermieror. Person me ose pa të drejta.
Lëviz në vendet ku jetojnë personat(strehim, squat, qendër akomodimi).
Mundësi për kujdes shëndetësor në Qendrën Shëndetësore 305 rue Paul Bert, 69003.
Për të caktuar takim:
04 78 14 14 15 ose contact@essip.fr

POLE SANTÉ SOLIDAIRE

Konsulta mjekësore, shëndet i përgjithshëm, dush (e martë dhe e enjte). Përkthim me interpret është i mundur. Për personat me ose pa mbulim mjekësor. Pranojnë kërkesat e para për AME.
→ **Mjek** (me takim):
Të hënën: ora 10:00–12:30 / 13:30–16:30
Të enjten: ora 10:30–12:30 / 13:30–15:30

→ **Dermatolog dhe pediatër:** caktoni takim me telefon (koha e pritjes: 15-30 ditë)

→ **PMI** (shëndeti i fëmijëve deri në 6 vjeç dhe ndjekja e shtatzënisë):
të mërkurën, ora 09:30–12:30, pa takim.

→ **Për personat me sigurim shëndetësor:** takim me mami i disponueshëm nëpërmjet Doctolib.
40 Avenue de la Table de Pierre, Francheville
C 24 / AU- 73 Spitali Antoine Charial
06 20 28 68 69 (përveç të premteve)

Tuberkulozi BCG dhe Vaksinimi

CDHS

Ekzaminimi për tuberkulozin dhe sëmundjet e frymëmarrjes. Konsulta pulmonologjike, radiografi të mushkrive, ndërprerje e duhanit. Vaksinime të detyrueshme falas dhe BCG (vaksinat sigurohen në vend).

→ 6 Qendra Shëndetësore në Rhône: Lyon, Villeurbanne, Vaulx en Velin, Vénissieux, Givors, Villefranche.
Të gjitha informacionet janë të disponueshme në: cdhs.fr
Caktoni një takim në doctolib.fr ose me telefon.

CDHS LYON

Vaksinime çdo ditë. Konsulta mjekësore me termin.
92 cours Vitton, 69006 04 72 73 12 76
M A M B T 1 Charpennes

Familja / Fëmijët

PASS - HOPITAL FEMME MERE ENFANT

Konsulta pediatrike (nën 16 vjeç)

Për të caktuar takim, telefononi ose dërgoni e-mail.
Sekretaria: nga e hëna në të premte: ora 08:00–12:00 04 72 11 81 65
hfme.passpediatrique@chu-lyon.fr
59 boulevard Pinel, 69500 Bron
T 6 Hôpitaux Est Pinel
C 8 / C 9 Hôpital Mère-Enfant

SPITALI ÉDOUARD HERRIOT – PASS PËR PERINATALITETIN

Shoqërim gjatë shtatzënisë. Me takim.
Sekretaria: nga e hëna në të premte, ora 09:00–16:00 (përveç të enjtes pasdite).
04 72 11 25 91, Takimi i parë duhet të caktohet nga një profesionist mjekësor social.
heh.passperinat@chu-lyon.fr
5 place d'Arsonval, 69003 (PAVILLON K, entrée 1) M D / T 2 Grange blanche

MBROJTJA E NËNËS DHE FËMIJËS (PMI)

Ndjekja e shtatzënisë, përgatitja për lindjen dhe për prindërimin, si edhe kujdesi shëndetësor për fëmijët deri në 6 vjeç.
Adresat dhe oraret janë të disponueshme në:
https://www.grandlyon.com/services/trouver-une-maison-de-la-metropole.html

QENDRA SOCIALE BONNEFOI

Hapësirë dëgjimi për prindër dhe fëmijë.
Një terapist familjar pret prindërit dhe fëmijët (0 deri në 12 vjeç). Shoqëron problematikat që lidhen me prindërimin dhe me rrugëtimin migrator. Shërbime përkthimi në dispozicion.
Me takim: 04 78 95 12 72
ose karine.jacquet@cdpr69.org
Pôle accès au droits, 11 rue de Turenne
M D Guillotiere

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Dhëmbë / Sy / Veshë

URGJENCA / PASS DENTAR

Vetëm në rast dhimbjeje ose infeksioni dentar. Sillni një dokument identiteti, nëse është e mundur.
Nga e hëna në të premte: ora 08:45–14:00
Të shtunën: ora 08:30–11:00 (ejani herët)
5 place d'Arsonval, 69003 (PAVILLON T)
M D T 2 Grange Blanche 04 72 11 03 61

→ **Për një kontroll dentar, dërgoni një email në:**
heh.passdentaire@chu-lyon.fr

DROIT DE REGARD

Syzet falas. Për ata që kanë mbulim nga sigurimi shëndetësor (CSS ose AME). Në rastin e AME-së, një punonjës social duhet së pari të marrë kontakt për të plotësuar një formular lidhës.
→ Merrni me vete këto dokumente kur të vizitoni dyqanin: kartën tuaj Carte Vitale ose certifikatën e sigurimeve shoqërore, kartën tuaj CSS ose AME dhe recetën tuaj.
6 rue Victor Hugo M D M A Bellecour
E martë deri të shtunën : 10-13:00 / 14-19:00
prevention@droitderegard.com

FRANCE HUMANITAIRE

I rezervuar për njerëzit pa mbulim mjekësor (as AME dhe as CSS). Të miturit duhet të shoqërohen. 04 72 73 09 25
Pa takim (regjistrimet fillojnë nga ora 15:00):
→ **Probleme dentare (vetëm për raste emergjence) : i mbyllur deri më 19 nëntor**
→ **Probleme me sytë:** E martë 13:30-17:30
15 rue Cavenne 69007 M D Guillotiere
Disa permanenca mund të anulohen; telefononi sekretarinë telefonike për t'u informuar.
I mbyllur më 1, 6, 20 dhe 27 tetor.

AUDITION SOLIDARITÉ

Për personat pa mbulim shoqëror ose që përfitojnë nga AME. Falas .
Kontroll dëgjimi, aparat dëgjimi dhe ndjekje vjetore. Konsultohuni fillimisht me një mjek ORL për të marrë një recetë, më pas kontaktoni Marion me e-mail ose me telefon (telefonatë ose SMS) për të caktuar një takim me një audioprotezist.
06 72 83 79 55
marion@auditionsolidarite.org

Shëndeti seksual / Çifti

SHOQATAT:

DA TI SENI

Sensibilizim dhe depistim për HIV / Hepatitin B dhe C me anë të TROD. Pa takim.
Të hënën, të martën dhe të enjten: ora 09:00–16:00 Të premten: ora 9-12:00
Përpara Forum Réfugiés SPADA, 336 rue Garibaldi M D Garibaldi 06 95 29 29 97

PLANNING FAMILIAL 69

Informacion rreth seksualitetit dhe marrëdhënieve. Konsultime për kontracepsionin, abortin, monitorimin e shtatzënisë dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme.
Përkthim me interpret është i mundur.
E hënë, e mërkurë, e enjte 9-12:00/13-18:00
E martë 13-18:00 E premte 9-12/13-16:00
2 rue Lakanal, Villeurbanne
T 1 / T 4 Tonkin 04 78 89 50 61
I mbyllur më 14 dhe 30 tetor, 11, dhe 18–19 nëntor.

→ **Qendrat e tjera bëjnë të njëjtën gjë (CSES) dhe ofrojnë mbështetje për jetën dhe shëndetin seksual të çiftit; shihni listën në faqja ne:**
https://www.grandlyon.com/centres-sante-et-education-sexuelles-cses

AIDES

Shoqata komunitare për luftën kundër AIDS-it dhe hepatitit viral. Mbështetje dhe shoqërim,akses në materiale sterile për parandalim. Grupet mbështetëse.
→ **Permanencë për akses në të drejta dhe në kujdes shëndetësor:** të martën, me takim.
→ **Depistim për HIV/VHB/VHC/Sifiliz (anonim dhe falas):** të martën, ora 14:00–19:00
→ **Për çdo pyetje, orientim ose për të caktuar takim:** nga e hëna në të premte, ora 11-18:00
110 rue Sully M A Masséna
06 34 45 51 27 / 04 78 68 05 05

ENIPSE

Kryesisht drejtuar personave LGBTQIA+.
Kontroll i shpejtë, anonim dhe falas për HIV dhe hepatit B/C. Konsultime për parandalimin e seksit me kimi (analiza e produktit është e mundur). Shpërndarje falas e prezervativëve, xhelave dhe materialeve për reduktimin e dëmit.
Të hënave dhe të enjteve, ora 14:00-20:00
6 rue Donnée 69001 M C Croix Paquet

ASSOCIATION DE LUTTE CONTRE LE SIDA

Sensibilizim dhe depistim për HIV / Hepatitin B dhe C me anë të TROD.
Të premten, ora 13:30–17:00, pa takim
Arche de Noé, 3 rue Félissent, 69007
T 1 Saint André 07 56 47 00 54

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

SHËRBIMET SPITALORE:

CEGIDD: QENDËR PËR DEPISTIM DHE KUJDES SHËNDETËSOR.

Depistim për HIV, hepatitin A/B/C, klamidia dhe sifiliz. Kujdes për Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme (përfshirë PrEP).
Për të caktuar takim:
→ **Me telefon** (ka shumë telefonata, provoni disa herë).

→ **Për njëtest jo urgjente, rezervoni një takim online në:**
https://www.chu-lyon.fr/cegidd-centre-gratuit-information-depistage-diagnostic-ist
(lidheni të premten në mëngjes që nga ora 09:00 për të pasur një orar për javën pasuese).

→ **Në rast rreziku të marrë më pak se 48 orë më parë, paraqituni urgjentisht pa takim.**

CEGIDD - SPITALI ÉDOUARD HERRIOT

Sekretaria: Të hënën, të enjten: 8:30-19:00
Të martën: 8:30-17:00
Të mërkurën dhe të premten: 08:30–16:00
5 place Arsonval 69003 (Pavillon K)
M D Grange Blanche 04 72 11 62 06

CEGIDD - SPITALI CROIX ROUSSE

→ **Sekretaria** : 04 26 10 94 73
nga e hëna në të enjte 10-12:30/14-16:30
Të premten 11:00-12:30 / 14:00-16:30
→ **Pritje në vend** : Të hënën: ora 08:30–18:00
Të martën: 09-18 Të mërkurën: 09-17
Të enjten: 08:30-18:30
Të premten: 10:30-16:30
103 Grande Rue Croix-Rousse M C Hénon

Shëndeti mendor

PASS VINATIER

Vetëm për personat pa të drejta shëndetësore. Konsulta psikologjike ose psikiatrike, vetëm me takim të caktuar në vend.
Receta mjekësore janë të mundshme.
Nga e hëna në të enjten: ora 09:00–12:00 / 14:00–17:00
Të premten: 09:00–12:00/13:30-16:00
04 37 91 52 07 për të caktuar takim
95, boulevard Pinel, 69500 Bron
T 2 T 5 T 6 Vinatier

Nr pa pagesë «Seksualiteti - Kontracepsioni - Aborti» **0800 08 11 11** (falas)

ECOUTE LYON BELLECOUR

Hapësirë për bisedë dhe dëgjim e vendosur në stacionin e metrosë Bellecour. Konsulta individuale, pa takim.
Nga e hëna në të premte: 12-19:00
Stacioni i metrosë Bellecour, linja e nivelit A, drejtimi Perrache përballë Mie Câline.
M D / M A Bellecour

CPCT – KONSULTA PSIKANALIZE

Për të rritur (18+). Falas. Mundësi për konsultë në anglisht. Nuk jep receta mjekësore dhe nuk vendos diagnozë.
Për të caktuar një takim, ju lutemi telefononi nga e hëna në të premte: 10:00-12:00 / 14:00-17:00
04 78 96 10 56
84, rue de Marseille M B Jean Macé
T 2 Centre Berthelot T 1 Rue de l'université

L'ESPACE -ORSPERE SAMDARRA

Hapësirë miqësore për takime dhe mbështetje. Aktivitete të shumta ofrohen çdo muaj. Pritje në anglisht, arabisht, tigrinja, amharisht, spanjisht, dioula / bambara dhe mooré.
Nga e hëna në të enjten: ora 14:00–17:15
→ **Rezervuar për gratë (fëmijët janë të mirëpritur):** Të mërkurën, ora 10:00–12:00
07 61 07 89 12
275 rue André Philip M B Place Guichard
I mbyllur më 8 tetor, dhe 11 nëntor.

CENTRE ESSOR - FORUM RÉFUGIÉS

Për azilkërkuesit, personat e sapoardhur, përfshirë refugjatët: të rritur, fëmijë mbi 6 vjeç dhe të mitur të pashoqëruar të marrë në kujdes nga MEOMIE.
Konsulta mjekësore dhe psikologjike. Seanca fizioterapie dhe art-terapie. Grupet e terapisë. Përkthim me interpret është i mundur.
Caktoni një takim me telefon ose email :
centredesante@forumrefugies.org
04 78 03 07 59
158 ter, rue du 4 août 1789
69100 Villeurbanne M A Flachet

Nr për informacion dhe orientim për shëndetin mendor i Vinatier: **08 05 05 05 69**
(falas, 7 ditë në javë nga ora 8:00 deri në 20:00)
contact@livesantementale.fr

Numri kombëtar për parandalimin e vetëvrasjes:
3114 (falas, 7 ditë në javë, 24 orë në 24)

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Varësitë

CAARUD-të presin dhe shoqërojnë përdoruesit e drogave (në mënyrë anonime dhe falas).

Akses në materiale për reduktimin e rreziqeve, infermieri, hapësirë higjiene, ndjekje, punëtori për reduktimin e rreziqeve, analizë produktesh dhe depistim i shpejtë (HIV, Hepatiti B dhe C).

CAARUD RUPTURES

Gjuhët e folura: Rusisht, Gjeorgjisht, Anglisht
04 78 39 34 89
→ **Pritje kolektive** (dushe, lavatriçe, kolacion):
Të hënën, të martën dhe të enjten, 09:30-13

→ **Pritje individuale :**
nga e hëna në të premte, ora 14:30–16:30.
36 rue Burdeau 69001
M C Croix-Paquet M A Hôtel de Ville

→ **Për dorëzimin e materialeve për reduktimin e rreziqeve:** telefononi në 06 30 52 02 96.

CAARUD - LE BUS

Akses në materiale për reduktimin e rreziqeve:
të dielën, ora 18:00–19:15
Place des Terreaux, 9 rue Édouard Herriot
M A Hôtel de Ville
të dielën, ora 20:00–21:30
përballë La Cantina, 172 rue Anatole France 69100 Villeurbanne M A Cusset

CAARUD PAUSE DIABOLO

→ **Akses në materiale:** të hënën: 10:00-20:00
të martën, të enjten dhe të premten: 10-18:00
të mërkurën: 10:00–13:00

→ **Pritje kolektive: :** të hënën: 14:30-17:30
të martën: 14:30–17:30 **(rezervuar për gratë)**
të mërkurën dhe të premten: 10:00–13:00
04 78 62 03 74
64 rue Villeroy 69003 M B Saxe Gambetta

Keni pyetje mbi të drejtat tuaja për shëndetin?

PROMOTION SANTÉ 69

Mbështetje për aksesimin e të drejtave të kujdesit shëndetësor për njerëzit që jetojnë në:
→ **Për personat që banojnë në Lyon 3 dhe 8**
→ **Meyzieu, Feyzin, Saint-Fons, Saint-Genis-Laval**
Të gjitha informacionet përmes kodit QR: ose në faqen e internetit.
mediation-sante@promotion-sante-ara.org

POLE SANTÉ SOLIDAIRE

Ndërmjetësim shëndetësor.
→ Të martën: me takim
→ Të enjten: pa takim
Për të caktuar takim: 06 20 28 68 69
nga e hëna në të enjten: 9:00-12:30/13:30-17
40 Avenue de la Table de Pierre, Francheville
C 24 / BUS 73 Spitali Antoine Charial

COMEDE

→ **Pyetje mbi aksesin në kujdes shëndetësor (si të përfitoni mbulim shëndetësor, leje qëndrimi për arsye mjekësore...).**
E hënë: 9:30-12:30 / 14:30-17:30
E premte: 9:30-12:30
01 45 21 63 12

→ **Pyetje në lidhje me një trajtim mjekësor ose një kontroll shëndetësor:**
E hënë, e martë: 14:30 - 17:30
E enjte 9:30-12:30
01 45 21 38 93

PUNË

Për të mësuar më shumë rreth ligjit të punës në Francë, shihni faqen 39.

YOON FRANCË

Shoqërim në kërkimin e një pune: informacione, këshilla, punëtori praktike dhe shërbime pritjeje. **I hapur për të gjithë personat me kombësi ose origjinë të huaj.**
→ Espace Bancel, 50 rue Bancel 69007
M B Jean Macé E hënë 14:00-16:30

→ La Cantina, 172 rue Anatole France 69100
M A Flachet E mërkurë 9:30-11:30
07 82 45 44 06 contact@yoonfrance.com
https://yoonfrance.com/

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

CNT-SOLIDARITÉ OUVRIÈRE

Informacion dhe mbështetje ligjore dhe sindikale për të mbrojtur të drejtat tuaja në punë. Punëtori kolektive informuese mbi rregullimin e statusit përmes punës. Të hapura për të gjithë personat e huaj, pa kushte.
Nuk ofrohet ndihmë për kërkimin e punës.
Me takim. Për të caktuar takim, telefononi ose dërgoni e-mail:
07 70 25 12 95 ud69@cnt-so.org
Union Régionale - Rhône-Alpes
8 rue Paul Lafargue M A Gratte-Ciel

WEAVERS

→ **Paratrajnim drejt punësimit:** frëngjisht (e përgjithshme dhe profesionale), aftësi për punësim, teknologji digjitale, zhvillim personal dhe praktikë në kompani. CDD ose CDI pas përfundimit të trajnimit. 4 muaj trajnim.
→ **Punëtori bisede në frëngjisht:**
E martë 18-20 06 25 09 56 82
50 cours de la République M A République
contact@weaversfrance.org
https://www.weaversfrance.org/programmes

ESCALE SOLIDAIRE HABITAT ET HUMANISME

Shërbim pritjeje për punësimin: krijim CV-je, ndihmë për kërkimin e punës / formimit, orientim, këshilla, përgatitje për intervista pune...
Të enjten: ora 14:00–17:00, pa takim
5 rue Hector Berlioz 69100 Villeurbanne
M A / M B Charpennes 09 74 13 73 23

CAUSONS

Trajnon persona në mërgim, në proces integrimi socio-profesional, për të mësuar gjuhën e tyre te një publik frankofon.
→ **Kurse kolektive të gjuhëve të huaja**
të zhvilluara nga persona në mërgim: anglisht, arabisht, armenisht, dari, spanjisht, persisht dhe rusisht. Për më shumë informacion: https://causons.org/
→ **Aktivitete kulturore dhe gjuhësore**
lyon@causons.org 06 26 65 30 20
Maison de l'Hospitalité, 236 cours Lafayette
M B Place Guichard T 1 Thiers Lafayette

SINGA

Për të gjithë. Punëtori për projektin profesional: Shkrimi i CV-së dhe letrës motivuese, përgatitja për intervistë.
Regjistrimi me telefon ose email:
06 64 41 30 66 employabilitelyon@singa.fr
Vendi i takimit jepet me SMS.

PROGRAMI I KURSO:

Shoqërim falas dhe i paguar për riaktivizim, kërkim pune dhe procedura administrative (strehim, lëvizshmëri, kujdes për fëmijët, patentë drejtimi...).
→ **Për personat që kanë vështirësi për të gjetur punë për shkak të prindërimit (kujdesi për fëmijët, prindërim i vetëm, etj.), që kanë autorizim për të punuar në Francë dhe që banojnë në Metropolin e Lionit.**

→ **Për personat mbi 40 vjeç që kanë autorizim për të punuar në Francë dhe që banojnë në Nouveau Rhône.**
Vetëm me takim paraprak. Më shumë informacion: 04 51 42 01 09
programme@kurso-rhone.fr

ORËT E PARA TË PUNËS NË KANTIER

Program integrimi përmes punësimit për personat pa strehë, të shoqëruar nga një edukator social. Disa vende në Metropolin e Lionit.
Për personat që kanë autorizim pune.
Me orientim nga një punonjës social.
phc-lyon@cvgce.org

Universiteti

RÉFUGIÉS ENSEIGNEMENT SUPÉRIEUR

Për refugjatët dhe azilkërkuesit.
Program shoqërimi drejt rifillimit të studimeve (konsulta individuale, punëtori, regjistrim universitar, bursë, strehim etj.).
12 rue Gabriel Péri, 69350, La Mulatière
M B Gare d'Oullins
contact@res-asso.org 06 69 12 98 66
https://res-asso.org/

KOLEKTIVI I STUDENTËVE TË HUAJ

collectif.etudiants.etrangers.lyon@riseup.net

HAPPYTOQUE

Aplikacion celular për studentët.
Shporta ushqimore dhe bileta kulturore falas.
https://happytoque.org

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

MËSO FRËNGJISHT

Mësime frëngjishteje

ERIS

→ **Kurs intensiv 5-mujor i gjuhës frënge, nga e hëna në të premte (niveli A1.1 deri në A2):** 9:30-16:00.

→ **Trajnim progresiv me mbështetje për të mësuar frëngjisht (niveli A0):** 3 mëngjese në javë.

→ Sesionet e ardhshme: Shtator 2026.
Për azilkërkuesit dhe refugjatët që janë fillestarë në frëngjisht.
Të gjitha kurset janë të detyrueshme.

→ **Orari i regjistrimit:** E mërkurë, 14:30-16 ose direkt në faqen e internetit:
https://eris-formation.org
formation@eris-association.com
La Boîte à Resorts, 13 bis rue Girié 69003
T 3 Dauphiné Lacassagne.

TIERS LIEU MAISON SÉSAME - SECOURS CATHOLIQUE

Informacione në pritje, pa takim.
→ **Kurse frënge për të gjitha nivelet (e rezervuar për azilkërkuesit) :**
Të martën dhe të premten: 09:15–11:30
Të mërkurën dhe të enjten: 14:15–16:30.

→ **Punëtori bisedash (e hapur për të gjithë) :**
E premte: 9:15-11:30
111 rue du 1er mars 1943, Villeurbanne
TB 11 C 23 C 27 Grand Clément
Maison Sésame (Secours Catholique du Rhône)

ITINÉRENS

Kurse frëngjishteje falas **(jo të hapura për të mitur)** pa regjistrim, për të gjitha nivele, në ambientet e ENS-së .
Kurse përgatitore për DELF A2, B1 dhe B2.
Shumë intervale kohore të disponueshme gjatë javës. Orari i kursit është i disponueshëm në Facebook, në faqen e internetit ose në tabelën e njoftimeve në sallën e ENS.

Itinerens itinerens.lyon@gmail.com
https://itinerens.wordpress.com/
15 parvis René Descartes
M B T 1 T 6 Debourg

ACT FOR REF

Mësime për të gjitha nivelet. Regjistrimi me email : act-for-ref@outlook.fr
Të martën : 18:30-20:00
Maison de l'Hospitalité, 236 Cours Lafayette
M B Part Dieu T 1 Thiers- Lafayette

ILE EGALITE (SOLIDARITE CUSSET)

Kurse për të gjitha nivelet, nuk kërkohet regjistrim.

→ **Fillestar :** E hënë 17:00-18:30
E premte 14-16:00

→ **Nivel mesatar:** E martë 17:00-18:30
E enjte 18:00-20:00

→ **I avancuar:** E mërkurë 18:00–20:00

→ **Mësime për të gjitha nivelet:**
E martë 18:30-20:00
E mërkurë 14-16:00 / 16-18:00

→ **Përgatitje për «test civique»:**
E mërkurë 18:00–20:00
Île Égalité, 6 rue de l'Égalité, Villeurbanne
M A Cusset
cours-francais-ile@riseup.net
Collectif Solidarités Cusset

TERRE D'HOMMES

Mësime falas në frëngjisht për të gjitha nivelet, nuk kërkohet regjistrim.
Të hënën, 18:00–19:30 (salla L.306)
Të mërkurën, 18:00–19:30 (salla L.208)
Lokalet e Sciences Po Lyon, rue du Professeur Charles Appleton, 69007
T 2 T 4 Centre Berthelot
→ Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:
07 67 46 84 98 ose 06 20 65 73 16
Terre d'Hommes Insta: @assoterredhommes
terredhommes@sciencespo-lyon.fr

SECOURS ISLAMIQUE

→ **Kurs frëngjishteje niveli A0 :**
E hënë, e martë: 14:30 - 16:00
→ **Niveli A1 :** E hënë, e martë, e merkurë, e premte : 10-11:30
→ **Niveli B1 :** E merkurë, e premte 14-15:30
Regjistrimi në vend ose me telefon:
E hënë deri të premten: 10:00-13:00 / 14:00-17:00 (përveç të enjten pasdite)
371 rue Garibaldi 04 27 11 87 87
T 2 Garibaldi - Berthelot / M B Jean Macé

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

CIMADE

Mësime falas të frëngjishtes.
Pasi të kryhet regjistrimi, do t'ju propozohet një kurs i rregullt në varësi të nivelit tuaj dhe disponueshmërisë suaj. 2 orë në javë.
→ **Datat e ardhshme të regjistrimit :**
7 nëntor : 10-12:00
6 nëntor : 17-19:00
Kontaktojini ata në: fle.lyon@lacimade.org
33 rue Imbert Colomes M A Hôtel de ville

CENTRE SOCIAL DES BUERS

Për banorët e Villeurbanne.
Punëtori frëngjishteje për të qenë të pavarur në jetën e përditshme.
→ **Gjatë ditës :** E martë 9:00-11:00
E enjte 14:00-16:00
→ **Në mbrëmje :** E martë 18:00-20:00

Regjistrimi: 04 78 84 28 33
ose linguistique@csbuers.fr
17 rue Pierre Joseph Proudhon, Villeurbanne
M A Flachet C 17 Louis Michel
C 69 Pierre Joseph Proudhon

DROIT POUR TOUS

Kurse për të gjitha nivelet, regjistrimi në vend.
Të martën dhe të enjten: 9:00-11:00
94 avenue St Exupéry (Kati përdhes, ana e autostradës), 69500 Bron.
M D Mermoz-Pinel BUS 15 Lionel Terray

FIL €

Kurse frëngjishteje, nivele të ndryshme. 5 vende në Lion. Pjesëmarrje e vogël financiare për shpenzimet e regjistrimit. Informacione rreth kurseve dhe regjistrimit mund të gjeni në faqen e internetit:
https://fil-fle-lyon.org/
filflelyon@gmail.com

CENTRE SOCIAL QUARTIER VITALITÉ €

Anëtarësimi në shoqatë kushton 9 €.
Punëtoritë e gjuhës frënge janë të disponueshme me regjistrim, me telefon ose email:
07 86 11 92 82 / 04 78 39 36 36
plp124@afi3.fr
→ Punëtori Fillestar absolut :
E enjte 14:00-16:00
Quartier Vitalité, 7 rue St Polycarpe 69001
M A Hotel de Ville

CPU €

Vetëm për azilkërkuesit (nën 40 vjeç) që kanë përfunduar të paktën 12 vjet shkollim dhe tashmë flasin pak frëngjisht.
Tarifa e anëtarësimit: 30 €. Mësime të rregullta gjatë gjithë vitit.
1 rue Bonald, 69007
T 1 Saint André M D Guillotiere
04 72 70 22 90 ose 06 17 51 15 38
accueil@cpu-lyon.org
CPU-LYON Instagram : @cpu.lyon

Punëtori bisedash

BIBLIOTEKA BASHKIAKE E LIONIT

Grup bisede në frëngjisht (FLE). Bisedë në frëngjisht; nevojiten njohuri bazë të gjuhës. Me ose pa regjistrim.
Informacioni mbi kursin është i disponueshëm në faqen e internetit të bibliotekës:
bm-lyon.fr (në "Les Rendez-vous", kërkoni për "Français Langues Etrangères")

SINGA BLABLA

Biseda në frëngjisht pa regjistrim.
→ E martë 17:00-19:00
236 Cours Lafayette
M B Part Dieu T 1 Thiers Lafayette

→ E mërkurë 16:00-18:30
12 Rue Gabriel Péri, Oullins La Mulatière
M B Gare d'Oullins BUS 15 Gare d'Oullins

Për programin e detajuar: 06 09 53 77 85
& Instagram "Singa Lyon"
communautelyon@singa.fr

OHLALA FRANÇAIS

Video dhe Facebook Live, të gjitha nivelet
ohlalafrancais

KARIBU

Aplikacion falas për të mësuar frëngjisht nga ukrainishtja, pashtoja dhe arabishtja.
https://www.bibliosansfrontieres.org

PARLERA

Faqja PARLERA.FR ofron kontakte dhe informacione praktike për të gjetur kurse trajnimi ose qendra provimi në frëngjisht në Rhône.
0800 970 669 (falas)
ecrit69@afi3.fr
Informacion rreth: https://parlera.fr/wp/cartographie-linguistique/

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

AKTIVITETE

CULTURE POUR TOUS

Përfitoni gjatë gjithë vitit nga bileta falas për teatër, koncerte, festivale, opera, kinema, muze, ekspozita, sport etj. Mund t'i gjeni te partnerët e tyre falë piktogramit ● në këtë udhëzues ose në faqen:
http://www.culture-pour-tous.fr

BIBLIOTEKAT KOMUNALE

Libra, kompjuterë, lidhje interneti, priza për pajisjet e karikimit. Në Lyon ka 16 biblioteka komunale.
Për të parë adresat dhe orarin e hapjes:
bm-lyon.fr

ILE ÉGALITE (COLLECTIF SOLIDARITE CUSSET)

→ **Teknika vetëmbrojtjeje në grup të rezervuar:**
E hënë 18:00-20:00

→ **Boksi popullor:**
të premten: 18-20:00 të shtunën 9-11:00

→ **Ndihmë me detyrat e shkollës:**
E hënë dhe e enjte: 16:30-18:00
Île Égalité, 6 rue de l'Égalité, 69100 Villeurbanne M A Cusset
Collectif Solidarités Cusset
Instagram: @collectif-solidarité-cusset

Të gjitha aktivitetet mund të gjenden në:
https://www.solidarites-cusset.org

TIERS LIEU MAISON SÉSAME SECOURS CATHOLIQUE ●

Hapësirë takimi dhe ndarjeje, e hapur për të gjithë.

→ **Hapësirë kafeje:**
të martën dhe të premten, 09:15–11:30
të mërkurën dhe të enjten, 14:15–16:30
të shtunën, 09:15–12:30

→ **Punëtori qepjeje:** E premte 9:15-12:00

→ **Punëtori gatimi:** Një të enjte në muaj, 9:15-14:00. Regjistrimi kërkohet në vend, ose në 06 38 36 89 51

→ **Parukeri për burra dhe gra pa takim:**
Të shtunën, 09:15–12:30

→ **Kohë miqësore** (vallëzim, muzikë, lojëra...):
Të enjten, 16:30–20:00

→ **Punëtori për riparimin e pajisjeve dhe të rrobave vetë :** Çdo të shtunë tjetër, 9-12:00
111 rue du 1er mars 1943,Villeurbanne
TB 11 C 23 C 27 Grand Clément
Maison Sésame (Secours Catholique du Rhône)

KABUBU

Aktivitete sportive falas, të hapura për të gjithë, me regjistrim.

→ **Ngjitje sportive:** E hënë 14:00-16:00
MRoc Part Dieu, 86 rue du Pensionnat

→ **Basketboll:**
Të përzier: të hënën, 20:15–22:00
Vetëm për gra: të hënën, 18:45-20:00
Gjimnazi i Grupit Shkollor Frida Kahlo, 1 Pl. Elsa Cayat, 69007

→ **Volejboll :** Të martën 18:00-19:30
Vitamine 7, 3 bis Rue Félix Brun 69007

→ **Vrapim:** të martën, 18:45-20:00
Maison de l'Hospitalité, 236 Cours Lafayette

→ **Yoga për gratë:** E mërkurë 18:15 - 20:15
Gjimnazi i shkollës Château Gaillard, 18 rue Montgolfier në Villeurbanne

→ **Padel:** E enjte 10:00-12:00
Sportfield, 15 rue Pré-Gaudry, 69007

→ **Yoga e përzier:** E enjte 18:00-19:30
Maison de l'Hospitalité, 236 cours Lafayette

→ **Badminton:** të premten, 18:00–19:30
të martën, 21:30–23:00.
Salle Cube de la SEPR, 46 Rue Professeur Rochaix 69003

→ **Boks i përzier:** Të premten, 15-16:30
Maison de l'Hospitalité, 236 Cours Lafayette

→ **Vallëzim:** E premte 20:00-22:00
Qendra Sportive Vaucanson, 4 rue Vaucanson, 69001
Aktivitetet mund të gjenden në faqja e internetit: https://www.kabubu.fr/fr/lyon
ose në Whatsapp : 07 82 77 58 64
Kabubu Lyon lyon@kabubu.fr

SINGA ●

Punëtori shkrimi, yoga, vallëzim, pikturë, ngjitje... Për të gjitha informacionet:
Grupi "Singa Lyon"
communautelyon@singa.fr
→ Seancë pa takim"Ejani, bëjini pyetjet tuaja Singa": Të martën 9:30-12:00
12 rue Gabriel Péri, La Mulatière
M B Gare d'Oullins 06 09 53 77 85

MONINGA - WOMEN OF SINGA ●

Shëtitje, aktivitete dhe evente kulturore gjatë gjithë vitit. E hapur për të gjitha gratë.
Për t'u bashkuar me grupin WhatsApp dhe për t'u informuar për të gjitha daljet dhe aktivitetet: dërgoni një mesazh te 06 09 53 77 85.
communautelyon@singa.fr

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

LES ESCALES SOLIDAIRES

Filma me ushqime të lehta, qepje, kor, yoga, gatim, parukeri dhe shumë aktivitete të tjera.
Regjistrohuni në njërën nga këto adresa ose në:
https://www.habitat-humanisme.org/ateliers/
252 rue Duguesclin 69003 04 81 09 16 93
M B Place Guichard T 1 Palais de Justice

5 rue Hector Berlioz 69100 Villeurbanne
M A / M B Charpennes 09 74 13 73 23

25 rue Delandine 69002
M A Perrache 09 82 81 35 90

78 rue Tronchet 69006 M A Massena
09 74 19 03 47

2 Place Dumas de Loire, 69009
M D Valmy 09 82 81 35 90

31 rue du professeur Rochaix, 69003
M D Grange Blanche 04 81 09 34 95

L'ESPACE DE L'ORSPERE SAMDARRA

Aktivitete shprehëse, sport, kërcim, muzikë... Orari i aktiviteteve është i disponueshëm në fillim të çdo muaji në:
www.orspere-samdarra.com
Nga e hëna në të enjten: ora 14:00–17:15
E mërkurë 10:00-12:00 **(vetëm për gratë)**
275 André Philip M B Place Guichard
I mbyllur më 8 tetor, dhe 11 nëntor.

LA CLOCHE

Aktivitete falas(kor, shkrim, gatim, etj.) dhe një rrjet tregtarësh që ofrojnë shërbime dhe produkte.
→ Seanca të shkurtra për të ndarë një moment miqësor me kafe/çaj, për të takuar njerëz të rinj, për t'u regjistruar në aktivitete dhe për të marrë kuponë për t'i shpenzuar në bizneset tona partnere: E martë 15:00-17:00
Flâneur Guesthouse, 56 rue Sébastien Gryphe M D Saxe Gambetta

Për më shumë informacion dhe për të mësuar datat e aktiviteteve: 07 67 85 78 32
La Cloche Auvergne-Rhône Alpes
Instagram: @laclocheaura

VILLA URBANA (WEAVERS)

Aktivitete për të lidhur njerëzit në mërgim dhe vendasit: punëtori sportive, mirëqenie, hobi krijuese, qepje, yoga, mësime frëngjishteje, etj. Falas dhe e hapur për të gjithë pa kërkesa statusi.
Programimi në:
https://www.weaversfrance.org/tiers-lieu
06 25 09 56 82
50 cours de la République M A République
villaurbana@weaversfrance.org

SECOURS ISLAMIQUE

→ **Parukiere me takim:**
Grua : Të mërkurën 10-17:00
Njeri : Të premten 10-13:00

→ **Punëtori qepjeje:** E martë, e premte 14:30-16:30

→ **Kuzhinë e përbashkët:** për gatim në ambientet e objektit, me rezervim.

Falas. Regjistrimi në vend ose me telefon:
E hënë, e martë, e mërkurë dhe e premte: 10-13:00 / 14-17:00 E enjte: 10:00-13:00
371 rue Garibaldi 04 27 11 87 87
T 2 Garibaldi - Berthelot / M B Jean Macé

LE RIZE

Program kulturor falas gjatë gjithë vitit, i disponueshëm në: http://lerize.villeurbanne.fr
23-25 rue Valentin-Haüy, Villeurbanne
C 23 / TB 11 Blanqui-Le Rize

TERRE D'ANCRAGES

Pritja dhe integrimi i personave të dëbuar.
Aktivitetet dhe oraret në:
https://terredancrages.org/agenda-activites/
Regjistrimi në 06 56 66 12 30
ose reseau@terredancrages.org

→ **Punëtori gatimi:** 20 maj në orën 17:30
La Cantina, 172 rue Anatole France, Villeurbanne M A Flachet
«Terre d'Ancrages»

ENTOURAGE

Aplikacion falas: aktivitete shoqërore dhe rrjet solidariteti për ndihmë të ndërsjellë.
→ **Mëngjesi:** të martën e fundit të muajit
Villa Urbana, 50 Cours de la République
Regjistrimi është i detyrueshëm për të gjitha aktivitetet (vende të kufizuara):
→ nëpërmjet aplikacionit Entourage
→ me mesazh në 07 78 22 77 90

SPORTING VILLEURBANNE

Stërvitje futbolli në grup të përzier dhe për të gjitha nivelet, nga 15 vjeç e lart:
të mërkurën, 18:00-20:00
Kompleksi sportiv i ENNA-së, Rue Henry Legay, Villeurbanne
M A Vaulx en Velin-La Soie 06 59 99 07 36

SOCIAL BASKATE

Seanca për të mësuar të bëjnë skateboard dhe për të krijuar lidhje sociale. I hapur për të gjithë, pavarësisht nivelit tuaj.
Kontaktoni me ta në Instagram: @socialbaskate
ose amandine@socialbaskate.com

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Prindërit / Fëmijët

HAPËSIRA PRITJEJE PËR PRINDËR DHE FËMIJË.

Hapësira të përshtatura për fëmijërinë e hershme (lojëra, hapësirë për zhvillimin motorik...). Hapësirë dëgjimi dhe ndarjeje për prindërit. **Të hapura për të gjithë prindërit me fëmijët e tyre. Anonim, pa regjistrim dhe falas.**
Fëmijë nën 4 vjeç dhe deri në 6 vjeç në disa vende. Mundësi për të takuar profesionistë të fëmijërisë së hershme.

→ **Më shumë se 10 hapësira pritjeje në Lyon:**
https://lacausedesparents.org/les-lieux-daccueil-enfants-parents-laep-a-lyon/

MBËSHTETJE PËR GRATË

NUMRI PËR DHUNËN NDAJ GRAVE - FALAS 24/7: 3919

PASSERELLES BUISSONNIERES

Mbështetje për gratë që përjetojnë izolim ose krizë socio-profesionale për shkak të mërgimit dhe/ose sëmundjes.
→ Mbështetje individuale dhe në grup, akses në të drejta, integrim socio-profesional, drejt autonomisë së secilit individ.

→ Mbështetje socio-ligjore dhe shëndetësore për gratë që kërkojnë azil dhe janë viktima të dhunës.

Takime vetëm me telefon (lini një mesazh zanor nëse nuk merrni përgjigje):
Të hënën, të martën dhe të enjten: 9:00-12:00 / 14:00–17:00
Të mërkurën dhe të premten: 9:00-12:00
04 26 17 47 18
contact@passerellesbuissonnieres.org
26 rue des Capucins M A Hôtel de ville

SECOURS ISLAMIQUE

Grup bisede për gratë, pa regjistrim.
Mëngjes i ofruar falas.
Të martën, 10:30-12:00.
371 rue Garibaldi, 69007
M B Jean Macé / T 2 Garibaldi - Berthelot

DA TI SENI

Një shërbim mbështetës dhe kujdesi për gratë dhe familjet që kanë pësuar gjymtimin e organeve gjenitale femërore.
E martë, 14:30–17:00
Centre Social Bonnefoi, 11 rue de Turenne
M B Saxe Gambetta M D Guillotière
Për më shumë informacion, ju lutemi telefononi: 04 78 00 10 39

VIFFIL - SOS FEMMES

Për gratë viktima të dhunës në çift.
Pritje e parë, dëgjim, informim mbi të drejtat dhe shoqërim në procedura.

→ **Për një seancë dëgjimore fillestare ose për informacion, ju lutemi telefononi:**
04 78 85 76 47
E hënë, e mërkurë, e premte: 9:30-12:30 / 13:30-17:00 E martë, e enjte: 9:30-12:30
viffil.association@viffil.com

→ **Të gjitha informacionet mbi shërbimet e pritjes fizike janë të disponueshme në faqen:**
https://www.viffil.com/contact-viffil/

QENDRA E INFORMACIONIT PËR TË DREJTAT E GRAVE DHE FAMILJEVE (CIDFF)

Qasje në të drejta, mbështetje për viktimat e dhunës, mbështetje për prindërit, mbështetje për kthimin në punë dhe për fillimin e bizneseve.

Nga e hëna në të enjten: 9-13:00 / 13:45-17
E premte: 9-13:00
→ **Këshillë ligjore në telefon :**
E hëna deri të premten 9-13:00
E entje 14-17:00
18 place Tolozan 69001
M A Hôtel de Ville 09 78 08 47 48

→ Për të parë të gjitha shërbimet e pritjes CIDFF në Lyon dhe rrethina:
https://rhonearcalpin-interdepartemental.cidff.info/liste-des-permanences/

CONSULTË PËR SHTATZËNINË, PERINATALITETIN DHE VARËSITË – CSAPA.

Konsulta për varësitë dhe psikoterapi për gratë shtatzëna ose që kanë lindur, që dëshirojnë një shtatzëni dhe që vuajnë nga varësitë.
Me takim, me telefon ose me e-mail:
04 26 73 25 90
nathalie.duvernay@chu-lyon.fr
CSAPA Hôpital de la Croix-Rousse Bâtiment C Kati 1, 103 Grande Rue de la Croix-Rousse
M C Hénon C 13 Hôpital Croix-Rousse

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

LGBTQIA+

AIMEL +

Pritje dhe përfshirje e migrantëve/eve dhe personave në mërgim LGBTQIA+. Shoqërim dhe akses në të drejta gjatë procedurës së azilit. Informacion mbi shëndetin (mendor dhe seksual). Në Lyon dhe rajonin përreth. Kontaktoni në frëngjisht, anglisht, spanjisht, rusisht dhe portugalisht.

→ **Shërbimet e ardhshme të pritjes:**
Të hënën më 12 tetor, 16:00
AIDES, 110 rue Sully M A Massena
Të shtunën më 31 tetor, 10:00
Centre LGBTQI+, 19 rue des Capucins
M A Hôtel de Ville
Caktoni një takim në: Insta: @aimel.plus ose aimel.association@gmail.com.

FONDATION LE REFUGE

Pritje, strehim i përkohshëm dhe shoqërim shumëdisiplinor për të rinjtë (+18 vjeç) viktima të LGBT+fobive dhe në situatë ndërprerjeje familjare.
Shkruani një e-mail për të marrë takim ose informacione: lyon@le-refuge.org
Linja kombëtare e dëgjimit (7 ditë në javë, nga ora 08:00 deri në 00:00): 09 39 03 63 03
29 rue de la Claire 69009 M D Vaise

2MSG - COLLECTIF REFUGIE AFRICAIN LGBTI+

Shoqatë e ndihmës së ndërsjellë për personat LGBT+ nga Afrika. Ndihmë për procedurat administrative (azil, ankime, CAF, punë). Mbështetje në jetën e përditshme dhe lufta për respektimin e të drejtave.
Lini një mesazh në 06 05 68 17 26
contact@asso2msg.org asso2msg

QENDRA LGBTI+

Pritje, mbështetje e ndërsjellë, luftë kundër diskriminimit, parandalim, aktivitete kulturore.
→ **Për të kontaktuar një vullnetar/e, telefononi në:** 08 05 03 11 81
nga e hëna në të premte: 09:00–21:00
të shtunën: 13:00–18:00
→ **Shërbim pritjeje dhe dëgjimi:** :
E martë, e merkurë: 17:30–19:30
të premten: 14:00–19:00
→ **Shërbim juridik:** të martën: 19:00-21:00, me takim. Caktoni një takim në social@centrelgbtilyon.org
19 rue des Capucins M A Hôtel de ville
Centre LGBTI Lyon / Insta @centrelgbtilyon
centrelgbtilyon.org

PUNË SEKSUALE / PROSTITUCION

CABIRIA

Shoqërim i përgjithshëm për personat në prostitucion / punonjësit e seksit.
→ Parandalim dhe depistim
→ Mbështetje ligjore (arrestime, dhunë, shfrytëzim, diskriminim, të drejta familjare)
→ Ndihmë administrative (dosje AME, CSS, azil) dhe adresë administrative.
→ Ndihmë financiare

Pritje pa takim: të hënën, 14:00–18:00
Pritje me takim: telefono 04 78 30 02 65
5 quai André Lassagne 69001
M A Hôtel de ville M C Croix-Paquet

Numër urgjence (24/7) : 06 07 62 26 59

AMICALE DU NID

Shoqërim për personat në situatë prostitucioni, qendër pritjeje ditore, akses në të drejta, integrim, adresë administrative, ndërmjetësim, shëndet dhe shëndet mendor, si edhe program për daljen nga prostitucioni.

→ **Caktim takimesh:** 04 78 27 28 20
nga e hëna në të premte: 9-12 / 13:15–17 (mbyllet të mërkurave pasdite)
29 rue St Jean de Dieu, Batiment B, Technopark 2, 69007 BUS 64 Carteret
T 6 Challemel-Lacour M B Debourg
I mbyllur më 15–16 tetor dhe më 11 nëntor.

MOUVEMENT DU NID - RHÔNE

Pritje dhe shoqërim për personat në situatë prostitucioni. Dëgjim, ndihmë administrative, akses në të drejta, kujdes shëndetësor, aktivitete kolektive, lidhje sociale dhe mbështetje për daljen nga prostitucioni.

→ **Pritje me takim:** : nga e hëna në të premte.

→ **Mësime frëngjishteje** : të martën, 10:30-12:00 (fillestar) / 14:00–15:30 (nivel mesatar)

70 rue Rachais 69007 M D Garibaldi
06 33 40 94 98
accompagnement-69@mouvementdunid.org

Copyright WATIZAT - WWW.WATIZAT.ORG

TË DREJTAT SOCIALE

KUSH MUND TË MË NDIHMOJË?

Mund të mbështeteni nga një punonjës social pavarësisht statusit tuaj. Nuk keni nevojë për asnjë dokument.
Mund të kërkoni ndihmë me: ushqimin, akomodimin, kujdesin shëndetësor, shoqërimin e familjeve dhe fëmijëve të vegjël, dhënien e një adrese administrative, etj.

Për të caktuar një takim:

→ **Nëse jetoni në Lyon :** kontaktoni Maison de la Métropole de Lyon (MDML) më të afërt me vendbanimin ose adresën tuaj administrative, ose paraqituni drejtpërdrejt në vend. Do të dëgjoheni, do të informoheni dhe më pas do të orientoheni drejt një personi përgjegjës që do t'ju shoqërojë në procedurat tuaja.

ARRONDISSEMENT-I I 1-RË

→ **MDML Neyret**
18, rue Neyret
M C Croix-Paquet
04 28 67 14 00

ARRONDISEMENT-I I 2-TË

Për azilkërkuesit.
Mbështetje sociale, ndihmë me procedurat (duke përjashtuar akomodimin).

→ **MDML Sainte-Hélène**
9, rue Sainte-Hélène
M D / M A Bellecour
04 28 67 17 00

ARRONDISEMENT-I I 3-TË

→ **MDML Corneille**
149, rue Pierre Corneille
M B Place Guichard
04 26 83 94 00

→ **MDML Sainte-Anne**
4, Place Sainte-Anne
T 1 T 4 Tiers Lafayette
04 28 67 23 40

ARRONDISEMENT-I I 4-TË

Familjet me fëmijë

→ **MDML Deleuvre**
51, rue Deleuvre
M C Hénon
04 28 67 22 10

ARRONDISEMENT-I I 5-TË

→ **MDML Cléberg**
5 bis, rue Cléberg Fourvière Funicular
04 28 67 22 50

ARRONDISEMENT-I I6-TË

→ **MDML Foch**
52, avenue Maréchal Foch M A Foch
04 28 67 23 60

ARRONDISEMENT-I I 7-TË

→ **MDML Bancel**
40, rue Bancel
M B Jean Macé
04 28 67 18 00

→ **MDML Félix Brun**
45, rue Félix Brun
M B Jean Jaurès
04 28 67 16 00

→ **MDML Madeleine**
36, rue de la Madeleine
M D Saxe-Gambetta
04 28 67 32 90

ARRONDISEMENT-I I 8-TË

→ **MDML Jean XXIII**
60 boulevard Jean XXIII
T 2 T2 Bachut
04 28 67 33 10

→ **MDML Jet d'eau**
219 avenue Berthelot
T 2 T 4 Jet d'eau
04 28 67 33 90

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

ARRONDISEMENT-I I 9-TË

→ **MDML Bourgogne**
15-17, rue de Bourgogne
M D Valmy
04 26 83 96 00

→ **MDML Duchère**
8, place Abbé Pierre
C 14 C 6 Duchère Martinière
04 28 67 22 80

→ **Nëse jetoni në zonat përreth Lionit:** kontaktoni MDML-në ose Qendrën Komunale të Veprimit Social (CCAS) të komunës suaj.

Adresat mund t'i gjeni në këtë faqe:

https://www.grandLion.com/services/trouver-une-maison-de-la-metropole.html

Shoqatat mund t'ju ndihmojnë gjithashtu në procedurat administrative dhe në hartimin e dokumenteve(shih faqe 7).

CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

Në Francë, personat pa leje qëndrimi ("pa dokumente" ose "në situatë të parregullt") kanë të drejtë:

→ **të shoqërohen në procedurat e tyre (faqja 30)**

→ **të marrin kujdes shëndetësor (faqja 38)**

→ **të përfitojnë strehim urgjent (faqja 33)**

Personat me leje qëndrimi ("në situatë të rregullt") kanë të drejta që varen nga statusi i tyre administrativ:

→ **Kërkesë për azil:** aksesi në të drejta i nënshtrohet disa kushteve dhe përfundon me mbylljen e procedurës së azilit (akomodim dhe ndihmë financiare, faqja 34, punë, faqja39).

→ **Refugjatët:** Të drejtat sociale janë të njëjta me ato të qytetarëve francezë (faqja 36).

→ **Leja e qëndrimit:** për personat që kanë një vërtetim për kërkesë leje qëndrimi (récépissé) ose një leje qëndrimi, të drejtat varen nga lloji i lejes së qëndrimit. Për shembull, jo të gjithë kanë të drejtë të punojnë (faqja39).

NË RAST ARRESTIMI

Mund të arrestoheni në rast të një kontrolli identiteti - për të verifikuar nëse keni të drejtë qëndrimi në Francë - dhe/ose në rast dyshimi për shkelje të ligjit.
Nëse jeni pa dokumente dhe ndaloheni nga policia, rrezikoni **të merrni një Detyrim për t'u Larguar nga Territori Francez (OQTF)** dhe, në disa raste, një masë qëndrimi të detyruar në një adresë të caktuar ose ndalim në një Qendër të Mbajtjes Administrative (CRA).
Dokumentet që duhet të keni me vete:

→ **Dokumentet që lidhen me procedurën tuaj** (vërtetimi i kërkesës për azil, kërkesa për leje qëndrimi etj.).

→ **Vërtetim iadresës administrative ose i strehimit.**

→ **Vërtetim i sigurimit shëndetësor (PUMA, CSS, AME), dokumentet që lidhen mendjekjen tuaj mjekësore, dhe të dhënat e kontaktit të mjekut tuaj.**

→ **Dokumente që që lidhen me situatën tuaj familjare në Francë:** vërtetim shkollimi i fëmijës suaj, certifikatë martese etj.

→ **Kartë telefonike dhe/ose telefon celular pa aparat fotografik.**

→ **Të dhënat e kontaktit (numri i telefonit) të një personi të besuar, të një anëtari të një shoqate dhe të një avokati, të cilët duhet të njoftohen menjëherë nëse ndaloheni ose vendoseni në qendër mbajtjeje administrative (CRA).**

⚠ Mbani kopje të dokumenteve tuaja në disa vende (në shtëpinë e një miku ose në një shoqatë) dhe në internet (në email).

Nuk është gjithmonë e këshillueshme të jepni pasaportën tuaj (edhe nëse ka skaduar), sepse kjo mund të lehtësojë largimin nga territori francez. Por mungesa e pasaportës mund të jetë një argument për t'ju vendosur në një qendër paraburgimi administrativ (CRA).

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

NËSE SHKONI TE ZYRAT E PAF-IT (POLICIA KUFITARE) OSE NË KOMISARIAT.

Mund të ndaloheni për një kontroll identiteti për maksimumi 24 orë dhe të vendoseni në paraburgim policor (garde à vue) për maksimumi 48 orë në rast dyshimi për shkelje të ligjit. Ju keni 4 të drejta thelbësore. Ata mund t'ju ndihmojnë të liroheni. Kërkoni:

→ një përkthyes: në gjuhën që flet më mirë, edhe nëse është e rrallë!

→ një mjek

→ një avokat

→ të telefononi një person të besuar, një shoqatë. Jepni detaje rreth arrestimit tuaj (ku, kur) në mënyrë që ata të mund t'ju ndihmojnë.

⚠ Mos nënshkruani asnjë dokument nëse nuk e kuptoni se çfarë është shkruar. Kërko të flasësh me një përkthyes!

NËSE LIROHENI

Nëse situata juaj nuk është e rregullt, mund të dilni nga komisariati me një OQTF (Detyrim për të Lënë Territorin Francez), ndonjëherë e shoqëruar me një IRTF (Ndalim i Kthimit në Territorin Francez). Ky vendim mund të shoqërohet me një urdhër arresti shtëpiak.

Kujdes, shpesh keni vetëm 48 orë nga momenti kur keni nënshkruar dokumentin për të paraqitur një ankim. Sapo të liroheni, kontaktoni shpejt një avokat ose një shoqatë për ndihmë (faqja <?>).

Nëse policia ju ka ofenduar dhe keqtrajtuar, mund të paraqisni një ankesë. Policia nuk mund të refuzojë të pranojë një ankesë, edhe nëse nuk keni dokumente. Nëse jeni goditur, mund të shkoni te një mjek dhe të merrni një certifikatë që vërteton lëndimet tuaja.

NËSE DËRGOHENI NË NJË QENDËR PARABURGIMI ADMINISTRATIV (CRA)

CRA-ja është një vend ndalimi, që ka për qëllim dëbimin tuaj ose drejt vendit tuaj të origjinës, ose drejt shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj për azil (procedura Dublin), ose drejt shtetit që ju ka dhënë mbrojtje ndërkombëtare (rikthim në kuadër të marrëveshjeve Schengen).

Në Lyon ka 2 CRA të vendosura pranë aeroportit Lyon-Saint Exupéry.

Me të mbërritur në CRA, kërkoni të takoni shoqatën e CRA-së.

→ Në Lyon: Forum Réfugiés.
Të afërmit tuaj gjithashtu mund të telefonojnë shoqatën për t'ju raportuar:
✆04 72 23 81 31

Ajo do t'ju ndihmojë me ankesat dhe mund t'ju mbajë të informuar për progresin e çështjes suaj. Në mungesë të Forum Réfugiés (fundjavave, ditëve të festave etj.), kontaktoni një shoqatë jashtë qendrës së mbajtjes (faqja<?>).

⚠ Për të dëbuar një person, shteti francez duhet të ketë pasaportën e tij të vlefshme ose një leje kalimi konsullor.

→ Nëse nuk keni paraqitur pasaportën tuaj dhe nëse refuzoni të takoni një përfaqësues konsullor të vendit tuaj, do të jetë e vështirë të merrni një leje kalimi: dëbimi juaj do të jetë i ndërlikuar.

→ Kujdes: Nëse refuzoni të takoheni me përfaqësuesin konsullor, mund të dënoheni me burgim (1 deri në 4 muaj).

→ Nëse keni dhënë një identitet të rreme, policia nuk do ta dijë nga cili vend vini. Kjo e bën dëbimin tuaj më të vështirë.
Kujdes, nëse policia zbulon se keni dhënë një identitet të rremë, mund të dënoheni me burgim (nga 1 muaj deri në 3 vjet).

SA KOHË NË CRA?

Periudha maksimale e ndalimit në CRA është 90 ditë. Ju keni dy mundësi për të kërkuar lirimin tuaj:

1. **Ankesa kundër urdhrit të paraburgimit** . Gjykatësi i lirive (JLD) ka 48 orë për të vendosur nëse do ta zgjasë apo jo periudhën e paraburgimit.

2. **Ankim kundër Urdhrit për Largim nga Territori Francez (OQTF)**. I kërkohet gjykatës administrative të anulojë vendimin e dëbimit (vetëm nëse ky vendim është i fundit, pra është marrë prej më pak se 48 orësh). Në varësi të vendimit të gjyqtarit, ju mund të liroheni ose masa e mbajtjes suaj administrative mund të zgjatet.
Nëse dënoheni dhe vendoseni në burg, rrezikoni të mbylleni përsëri në një Qendër të Mbajtjes Administrative (CRA) në përfundim të dënimit me burg.

WATIZAT, TOUS DROITS RESERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

TË DREJTAT TUAJA NË PARABURGIM:

→ **Të telefononi nga kabinat telefonike të qendrës ose me telefonin tuaj celular pa aparat fotografik.** Telefonat celularë që mund të bëjnë fotografi konfiskohen. Të dashurit tuaj mund t'ju telefonojnë edhe nga kabinat telefonike.

→ **Të merrni vizita nga të afërmit tuaj.** Ata duhet të jenë në situatë të rregullt qëndrimi dhe të paraqesin një dokument identiteti. Ata mund të sjellin rroba, ushqime me afat të gjatë ruajtjeje dhe të paketuara individualisht (biskota, pije freskuese), dokumente, para, një telefon celular pa aparat fotografik dhe cigare.

→ **7 ditë në javë, nga ora 09:30 deri në 11:30 dhe nga ora 14:00 deri në 18:15**
60 rue du Royaume-Uni, 69125 Colombier Saugnieu
BUS 47 Aéroport St-Exupéry Air Parc ose Rhône Express Lion St-Exupéry

→ **Të merrni vizitën e një shoqate ose të një kolektivi mbështetës:**

COLLECTIF LYON ANTICRA

Kolektivi mbështetës për personat e ndaluar në CRA-në e Lionit.
Luftë për heqjen e qendrave të paraburgimit, fundin e izolimit dhe fundin e deportimeve. Anëtarët e tij mund t'ju vizitojnë dhe të publikojnë dëshminë tuaj në faqen e tyre të internetit. Kolektivi organizon gjithashtu veprime dhe mobilizime politike për t'ju mbështetur.

→ **Nëse jeni i ndaluar, të afërmit tuaj mund t'u shkruajnë një mesazh për të hyrë në kontakt me ju:**
lyonanticra@riseup.net
«Lyon Anticra»
https://crametoncralyon.noblogs.org/

Aplikoni për ndihmë për kthim vullnetar nga OFII, për t'u kthyer në vendin tuaj të origjinës. Për disa vende, ndihma për riintegrim ofrohet në vendin tuaj të origjinës.
http://www.retourvolontaire.fr/

TË KESH NJË KUTI POSTARE:

ADRESA ADMINISTRATIVE

Adresa postare administrative është një adresë ku mund të merrni postën tuaj kur nuk keni një vendbanim ose strehim të qëndrueshëm.
Një adresë postare administrative është e detyrueshme për procedurat tuaja administrative!

Për azilkërkuesit

Kur filloni procedurën tuaj të kërkesës për azil në Lion, Forum Réfugiés (SPADA) duhet t'ju sigurojë një adresë postare administrative. Edhe kur jeni në procedurë Dublin dhe prefektura ju ka konsideruar si person "në arrati", SPADA duhet të vazhdojë t'ju sigurojë adresën postare administrative. Adresa e regjistruar do të jetë ose:
→ **Në Maison du Réfugié (SPADA)**
→ **Në qendrën tuaj të akomodimit**
→ **Në adresën e vendbanimit tuaj, nëse ju ose një nga të afërmit tuaj (prindërit, vëllai ose motra) është qiramarrës. Një letër akomodimi nga një mik nuk pranohet.**

Për refugjatët

Nëse përfitoni nga mbrojtja ndërkombëtare (status refugjati, mbrojtje subsidiare ose status apatridi), mund të vazhdoni të përfitoni nga adresa postare administrative dhe nga shoqërimi i SPADA-s për një periudhë prej 6 muajsh. Për të gjetur një adresë të re, Forumi Réfugiés mund t'ju ndihmojë, përndryshe shihni: "situata të tjera".

Për situata të tjera

Nëse jeni pa dokumente ose në një situatë të veçantë dhe nuk keni adresë, mund të kërkoni një adresë postare administrative:

→ **Në Qendrën Komunale të Veprimit Social (CCAS) të rrethit ose bashkisë ku jetoni.** CCAS-të ndodhen në **Maisons de la Métropole (MDML)**, të pranishme në çdo lagje (arrondissement) të Lionit (faqja 29).
Për të përfituar nga një adresë postare administrative, duhet të provoni lidhjen tuaj me lagjen (arrondissement) përkatëse.

→ **Në një qendër pritjeje ditore që ofron shërbimin e adresës postare administrative (faqja 16).**

⚠ Është e vështirë të gjeni një adresë postare administrative. Kërkoni këshilla nga një shoqatë.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

AKOMODIMI



→ AKOMODIMI është i përkohshëm dhe i pakushtëzuar: ju mund të kërkoni akomodim edhe nëse nuk keni dokumente. Ekziston një akomodim specifik për azilkërkuesit (faqja34).

→ Akomodimi është afatgjatë. Të aksesueshme vetëm për personat në situatë të rregullt (azilkërkues, mbajtës të lejes së qëndrimit ose të një vërtetimi rinovimi të lejes së qëndrimit). Kërkohet një kontribut financiar.

Për një natë

Për këdo që nuk ka strehim: 115
Koha e pritjes në telefon mund të jetë 30 minuta ose më shumë. Duhet të telefononi disa herë derisa të dëgjoni mesazhin e mirëseardhjes, pastaj të qëndroni në linjë për të folur me një person. Numri i vendeve është i pamjaftueshëm; është e rrallë të sigurohet një vend çdo natë.

Mund të telefononi në numrin 115, 24 orë në 24.

→ Tregoni nëse jeni në një situatë vulnerabël (sëmundje, fëmijë, grua e vetme etj.).

Një strehim më i qëndrueshëm.

Mund të kërkoni të bëhet një "diagnostikim MVS" për të përfituar një strehim më të qëndrueshëm, me ndihmën e një punonjësi social, ose duke telefonuar në numrin **115** apo**Maison de la Veille Sociale** .
Kjo quhet " **kërkesa SIAO**"

→ Koha e pritjes për të përfituar një strehim është shumë e gjatë. Familjet dhe personat e sëmurë kanë përparësi.

→ Duhet ta konfirmoni dosjen çdo 2 muaj pranë MVS-së ose në nr 115 dhe të njoftoni çdo ndryshim të situatës suaj (adresë, nr telefoni, situatë familjare etj.).

→ Vazhdoni të telefononi 115 për të pasur më shumë mundësi të përfitoni një strehim më të qëndrueshëm.

MAISON DE LA VEILLE SOCIALE (MVS)

Me takim. Vetëm për personat pa referent social dhe pa kërkesë në proces(nuk pranojnë azilkërkuesit, personat që jetojnë në qendra akomodimi dhe personat që kanë kontratë qiraje).
Pritje telefonike: nga e hëna në të premte (përveç të enjtes): 9:00-12:00
04 78 95 00 01
contact.mvs@mvsrhone.fr
Nëse keni dokumente të rregullta, mund të bëni gjithashtu një kërkesë për strehim të përkohshëm ose për banesë sociale(faqja 36).

Nuk po arrini të gjeni strehim?

Keni bërë një kërkesë SIAO, telefononi prej kohësh në numrin 115 dhe koha e pritjes është shumë e gjatë: Mund t'i drejtoheni Prefekturës (duke bërë një ankim) për të përfituar strehim nëpërmjet DAHO (e drejta e kundërshtueshme për strehim urgjent). Për DAHO-n, duhet të plotësoni kushtet e mësipërme dhe të provoni se:
→ Jeni në një situatë strehimi të papërshtatshëm(pa banesë, të strehuar te të afërmit, në hotel), në kushte të këqija ose me strehim të paqëndrueshëm.
→ Keni kërkuar një strehim urgjent ose, nëse keni dokumente të rregullta, një strehim të përkohshëm, dhe nuk keni marrë asnjë përgjigje.

Keni nevojë për ndihmë?

→ Je mbi 30 vjeç
→ Adresa juaj është në zonën metropolitane të Lionit ose në departamentin e Rhonës (duke përjashtuar Villeurbanne):

ALPIL

→ Kontakti fillestar me telefon:
Të martën dhe të mërkurën: 16:00–18:00
04 37 70 67 47
→ Pritja e parë në vend, pa takim:
Të mërkurën dhe të enjten: 09:00–11:00
281 rue de Crequi M D / M B Saxe-Gambetta
I mbyllur nga 19 deri më 23 tetor.

→ Adresa juaj është në Villeurbanne:

AVDL

Kontakti fillestar me telefon:
04 72 65 35 90 avdl.asso@avdl.fr
Të hënën: 13:30-17:30
Të martën, të mërkurën dhe të enjten: 09:00–12:30 / 13:30–17:30

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

→ **Je nën 30 vjeç**
→ **Adresa juaj është në Lion ose përreth (duke përjashtuar Villeurbanne dhe Venissieux):**

CLLAJ LYON

→ **Pritja e publikut:** Të hënën: 13:30–17:00
Të martën, të mërkurën dhe të enjten: 9:00–12:30 / 13:30–17:00.
→ **Shërbim informimi**: të martën dhe të enjten: në orën 13:45 dhe 15:45

→ **Pritje telefonike:**
të martën, ë mërkurën dhe të enjten: 9:30–12:30 / 13:30–17:00
04 72 07 87 17 cllaj.lyon@cllajlyon.fr
Place du Forez, 69001 Lyon
M C Croix-Paquet M A Hôtel de Ville

Strehimi i të miturve të pashoqëruar
Nëse kërkoni njohjen e statusit të të miturit të pashoqëruar (MNA) dhe mosha juaj ende nuk është vlerësuar, keni të drejtë për strehim gjatë periudhës së vlerësimit të moshës suaj. Strehimi juaj sigurohet nga CMAE i Forum Réfugiés dhe nga MEOMIE, të cilët janë përgjegjës për akomodimin tuaj (faqja 5).

Situata në Lion është shumë e vështirë për personat të cilëve MEOMIE ua ka refuzuar njohjen e të miturit dhe që kanë paraqitur ankim pranë gjyqtarit për të mitur për t'u njohur si të tillë.Shumë të rinj flenë në squate ose në rrugë.

Nëse nuk ju është njohur statusi i të miturit, njoftimi i refuzimit ju jep të drejtën të kërkoni një strehim për të rritur (faqja33). Mund të telefononi në 115 dhe të shpjegoni situatën tuaj.

KUSHTET MATERIALE PËR PRITJE: CMA

CMA (Kushtet Materiale për Pritje) janë të rezervuara për azilkërkuesit. OFII jua propozon këto kushte pritjeje kur paraqiteni në sportelin unik të prefekturës. Këto ndihma mund të jenë:

→ **një pagesë mujore (ADA)**
→ **e drejta për akomodim**

Për të përfituar nga këto ndihma, duhet të nënshkruani formularin që ju jep OFII në Sportelin Unik, duke deklaruar se pranoni Kushtet Materiale të Pritjes (CMA).

Ose kërkoni strehim dhe ndihmën financiare, ose kërkoni vetëm ndihmën financiare duke deklaruar se jeni të strehuar në mënyrë të qëndrueshme.

Nëse keni kërkuar strehim dhe ai ju është refuzuar, atëherë shuma e ndihmës financiare ADA do të jetë më e lartë.

ADA: Ndihma financiare për azilkërkuesit

Karta ADA është një kartë pagese që ju lejon të merrni ndihmën tuaj financiare çdo muaj. Nuk është e mundur të kryhen pagesa në internet me këtë kartë.
Ju do të merrni ndihmën tuaj ADA në fillim të çdo muaji gjatë procesit të aplikimit për azil. Shuma e ADA-së (afërsisht 7 €/ditë) varet nga situata juaj familjare (beqar, në çift, me familje) dhe nëse jeni të akomoduar apo jo.

Pasi të keni marrë kartën, duhet të prisni nga 30 deri në 45 ditë që ajo të aktivizohet.

Për të kontrolluar sa para ju kanë mbetur në kartën tuaj ADA, mund të telefononi 05 32 09 10 10. Ose shkarko aplikacionin Up cohésia në telefonin tuaj nëpërmjet Google Play ose App Store. Për më shumë informacion se si të instaloni dhe përdorni aplikacionin: https://watizat.org/wp-content/uploads/2020/12/ADA_FR.pdf

Karta ime është bllokuar, vjedhur, humbur: çfarë duhet të bëj?

1. Telefononi në këtë numër për të çaktivizuar kartën: 05 32 09 10 10
2. Caktoni një takim në OFII në Lion për të marrë një kartë të re

OFII LYON

lyon@ofii.fr
04 72 77 15 40
7 rue Quivogne, 69286, Lyon Cedex 02.
Nëse nuk e merrni ose nuk e merrni më ndihmën ADA, mund të kontaktoni OFII-në e Lionit.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Qasja në akomodim për azilkërkuesit

Si azilkërkues, dhe nëse keni pranuar kushtet materiale të pritjes të ofruara nga Ofii në sportelin e vetëm, keni të drejtë për një vend në një qendër strehimi për azilkërkues (CADA, HUDA, PRAHDA, etj.).

⚠ Ju nuk keni të drejtë të zgjidhni rajonin ose qytetin në të cilin do të akomodoheni. Mund të akomodoheni larg qendrës së qytetit të Lionit, në një qytet tjetër ose në fshat.
Nëse e refuzoni propozimin e OFII-së, nuk do të keni më të drejtë për akomodim dhe nuk do të merrni më ndihmën ADA.

Në Francë, jo të gjithë azilkërkuesit janë të akomoduar për shkak të mungesës së hapësirës. Familjet, personat e sëmurë ose personat që paraqesin një gjendje shumë të lartë vulnerabiliteti kanë përparësi.

Nëse po aplikoni për azil dhe nuk keni akomodim:

→ **Paraqituni në SPADA (Forum Réfugiés).**

→ **Për strehim urgjent, telefononi 115 (faqja 33)**

→ **Mund të pushoni gjatë ditës dhe të kërkoni ndihmë në një qendër pritjeje ditore (faqja 15)**

Refuzimi / tërheqja e Kushteve Materiale të Pritjes (CMA).

Kushtet Materiale të Pritjes (CMA) mund të refuzohen:

→ **Nëse jeni në procedurë rishqyrtimi të kërkesës suaj për azil,**

→ **Nëse nuk e keni paraqitur kërkesën tuaj për azil brenda 90 ditëve pas mbërritjes në Francë, pa një arsye të ligjshme,**

→ **Në rast mashtrimi, fshehjeje informacioni ose dhënieje të informacioneve të rreme,**

→ **Nëse refuzoni një strehim ose nëse nuk shkoni në rajonin ku OFII ju ka orientuar.**

Ato mund të hiqen gjithashtu:

→ **Nëse refuzoni ose braktisni një strehim** (për shembull, nëse ktheheni në Paris pasi jeni orientuar drejt një qyteti tjetër në Francë),

→ **Nëse përjashtoheni nga vendi i strehimit që ju është caktuar nga OFII**(për shembull, në rast sjelljeje të dhunshme ose shkeljeje të rëndë të rregullores),

→ **Nëse nuk respektoni detyrimet e vendosura nga autoritetet**(mosmarrja pjesë në thirrjet e prefekturës për personat në procedurë Dublin, refuzimi për të dhënë informacion, mungesa në intervista etj.).
OFII duhet t'ju japë një dokument që shpjegon arsyen e refuzimit ose të pezullimit. **Kërkojeni nëse nuk jua japin, sepse është shumë i rëndësishëm për të bërë një ankim kundër këtij vendimi.**

Kërkoni rivendosjen e Kushteve Materiale të Pritjes (CMA)

"Ankimi" (recours) ju lejon të kundërshtoni një vendim administrativ përpara drejtësisë.

1. **Nëse merrni një dokument nga OFII** që njofton synimin për të refuzuar ose pezulluar Kushtet Materiale të Pritjes (CMA), keni 15 ditë afat për të dërguar një letër me identitetin tuaj dhe arsyet tuaja për të kundërshtuar këtë vendim. Duhet ti dërgohet OFII-t 7 rue Quivogne, 69 286 Lyon CEDEX 02.

Nëse vendimi mbetet në fuqi, kjo letër do të jetë më pas shumë e dobishme për avokatin tuaj për të paraqitur një ankim administrativ.

2. **Nëse vendimi për pezullimin e Kushteve Materiale të Pritjes (CMA) mbahet në fuqi, mund të:**
→ t'i drejtoheni Drejtorit të OFII-së me një ankim administrativ paraprak (recours gracieux) kundër këtij pezullimi të CMA-së, brenda një afati prej dy muajsh.
✉ contentieux.cma@ofii.fr

→ paraqisni një ankim kundër vendimit për pezullimin e Kushteve Materiale të Pritjes (CMA) pranë gjykatës administrative, brenda një afati prej dy muajsh.

Nëse CMA-ja juaj është pezulluar ose refuzuar prej më shumë se dy muajsh, ju mund të kërkoni ende rivendosjen e saj pranë OFII-së duke dërguar një letër rekomande në selinë e OFII-së ose një e-mail në: ✉ contentieux.cma@ofii.fr

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

3. Nëse përgjigja është negative ose nëse Ofii nuk përgjigjet pas 2 muajsh, keni 2 muaj për të apeluar në gjykatën administrative për të kundërshtuar këtë vendim. Këtë procedurë mund ta kryeni gjithashtu nëse nuk e keni marrë letrën që ju njofton për pezullimin e Kushteve Materiale të Pritjes (CMA).

⚠ Këto dokumente janë të vështira për t'u hartuar dhe afatet për paraqitjen e ankimimeve ndryshojnë sipas situatës suaj. Kështillohet fuqimisht të shkoni në një shërbim juridik për t'u shoqëruar nga një avokat (faqja9).

Raste të veçanta

Kërkoni rivendosjen e CMA-së:
Për personat e "riklasifikuar", pra ata që kanë kaluar në procedurë normale ose të përshpejtuar pas procedurës Dublin, ndiqni të njëjtën procedurë për kërkesën e rivendosjes së Kushteve Materiale të Pritjes (CMA) si ajo e përshkruar më sipër.
Për personat që janë kthyer në Francë pas një transferimi Dublin: është e mundur të paraqitet drejtpërdrejt një ankim pranë gjykatës administrative kundër vendimit të OFII-së për refuzimin e CMA-së.

⚠ Duhet të provoni gjendjen tuaj të vulnerabilitetit dhe të shpjegoni pse mungesa e strehimit dhe e ndihmës financiare ju vë në rrezik. Për shembull: një certifikatë mjekësore që vërteton një sëmundje të rëndë.

Nëse ju jepet statusi i refugjatit

Kur ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja plotësuese, **Ju nuk konsideroheni më azilkërkues.** : nuk keni më të drejtë për të njëjtat vende akomodimi. **Ju keni të drejtë të aplikoni për banesë sociale.**
→ Kërkoni ndihmë pranë SPADA-s (Forum Réfugiés), qendrës suaj të strehimit ose një punonjësi social në qytetin tuaj (faqja 29). **Në Lion, mund të përfitoni nga programi i integrimit Accelair.**

BANESA

Banesa sociale është e aksesueshme nëse:
→ **Ju keni një leje qëndrimi të vlefshme.**

→ **Ju keni burime financiare (duke përfshirë përfitimet sociale si RSA)**
Nëse i plotësoni këto kushte, mund të aplikoni për benesë sociale.

Banesë e përkohshme / Banesë tranzitore

Strehimet e përkohshme / strehimet tranzitore i presin personat për një periudhë të kufizuar: qira solidare, rezidenca sociale dhe pensione familjare. Kërkohet një kontribut financiar, me mundësinë për të përfituar një ndihmë financiare: APL.
→ **Për të bërë këtë kërkesë, duhet të plotësoni një dosje MVS me ndihmën e një punonjësi social. Ju duhet ta përditësoni aplikimin tuaj çdo tre muaj.**

→ **Mund të aplikoni edhe në faqet e internetit të Adoma dhe Aralis.**

Banesë sociale.

Banesa sociale është një banesë afatgjatë me një qira të ulët.

⚠ Personat që kanë një vërtetim (récépissé) për kërkesën e parë të lejes së qëndrimit nuk mund të përfitojnë një banesë sociale. Duhet të keni një leje qëndrimi ose një vërtetim për rinovimin e lejes së qëndrimit.

Për të kërkuar një banesë sociale, duhet të plotësoni një formular:
→ **Në internet:**
www.demande-logement-social.gouv.fr
→ **Në bashkinë e qytetit**
→ **Pranë një organizmi të banesave sociale**
Ju mund ta bëni kërkesën për veten tuaj dhe për anëtarët e familjes suaj (bashkëshortin/en, partnerin/en dhe fëmijën/fëmijët, gjyshin/gjyshen, prindin, nipin/mbesën, vëllain ose motrën), nëse ata janë në situatë të rregullt qëndrimi.

⚠ Ju duhet ta përditësoni kërkesën tuaj sa herë që situata juaj ndryshon (familjare, financiare etj.) dhe ta rinovoni kërkesën çdo vit. Ju mund të kërkoni ndihmën e një punonjësi social (faqja 29).

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Skema e ndihmës për strehim “Action Logement”

Nëse punoni në një kompani që punëson më shumë se 10 punonjës, mund të keni të drejtë për "Action Logement". Pyetni punëdhënësin tuaj nëse mund të përfitoni nga kjo skemë. Nëse po, plotësoni një formular online: https://www.actionlogement.fr

A keni vështirësi në gjetjen e banesës?

Mund të paraqisni një ankim për të përfituar një banesë nëpërmjet DALO-s (e drejta e kundërshtueshme për banesë). Ai ju lejon t’i drejtoheni prefekturës kur ndodheni në një situatë strehimi të papërshtatshëm (pa banesë, nën kërcënim dëbimi pa zgjidhje ristrehimi, në një banesë të mbipopulluar, ose kur koha e pritjes për një banesë është jashtëzakonisht e gjatë etj.).

Nëse ju është dhënë azil (status refugjati ose mbrojtje subsidiare) dhe nuk keni banesë, mund të paraqisni një ankim DALO 6 muaj pasi të keni dorëzuar një kërkesë për banesë sociale.

Kohët e përpunimit të aplikimeve në prefekturë janë të gjata: normalisht 3 muaj, por aktualisht 9 muaj).

Mund të shoqëroheni nga ALPIL, AVDL ose CLLAJ në varësi të moshës dhe vendbanimit tuaj, shih faqen 33.

€ NDIHMAT

Një ndihmë financiare është një shumë parash e dhënë nga shteti në kushte të caktuara. Shuma ndryshon në varësi të statusit tuaj administrativ, moshës suaj, përbërjes së familjes suaj, akomodimit tuaj...

⚠ Për azilkërkuesit: shih ADA (faqja 34)

Të Ardhurat Aktive të Solidaritetit (RSA)

Mund ta kërkoni nga Fondi i Ndihmës Familjare (CAF), në faqen e internetit www.caf.fr, në këto kushte:

→ Të jesh shtetas i huaj me status ligjor për të paktën 5 vjet me një leje qëndrimi të vlefshme që autorizon punën OSE të jesh refugjat, përfitues i mbrojtjes plotësuese ose person pa shtetësi.

→ Të jesh mbi 25 vjeç OSE të jesh nën 25 vjeç dhe të kesh të paktën një fëmijë në ngarkim, të lindur ose të palindur OSE të jesh nën 25 vjeç dhe të kesh punuar 2 vjet në 3 vitet e fundit.

→ Nuk ka të ardhura ose ka të ardhura të ulëta

→ Të banoni në Francë në mënyrë të përhershme dhe të qëndrueshme.

Nëse jeni azilkërkues, mund të aplikoni për RSA, por ajo do t'ju jepet vetëm nëse ju jepet azil. Kur t'ju jepet azil, kontaktoni CAF-in me numrin tuaj të aplikimit RSA. Pastaj do ta merrni atë për çdo muaj nga data e kërkesës suaj.

Ndihma të tjera

Mund të jenë të disponueshme edhe pagesa të tjera në varësi të situatës suaj familjare, situatës profesionale ose kushteve të akomodimit. Një punonjës social mund t'ju ndihmojë me këto hapa (faqja 29).

QASJA NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor

Nëse nuk keni Ndihmë Mjekësore Shtetërore (AME) ose Mbrojtje Universale Shëndetësore (PUMA-CSS), mund të:

→ Shko te Qasja në Klinikat e Kujdesit Shëndetësor (PASS) të vendosura në spitale (faqja17). Do të kujdeseni nga mjekë dhe punonjës socialë, dhe do t’ju jepen ilaçe falas.

→ Shoqata të ndryshme ofrojnë gjithashtu ndihmë për të përfituar të drejtat tuaja në fushën e shëndetit. (faqja 18)

→ Në rast urgjence jetike, duhet të telefononi në numrin 15 (SAMU) ose të paraqiteni në shërbimin e urgjencës më të afërt.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

⚠ Kujdesi shëndetësor është me pagesë dhe do të merrni një faturë (rrezik borxhi). Nëse jeta juaj është në rrezik, mund të përfitoni nga një rimbursim i veçantë i shpenzimeve të kujdesit shëndetësor.

Mbrojtja Universale e Shëndetit (PUMA-CSS, më parë CMU)

Personat me leje qëndrimi.

Nëse ndodheni në Francë prej të paktën 3 muajsh dhe keni një leje qëndrimi (kërkesë për azil, récépissé, leje qëndrimi), mund të përfitoni nga Mbrojtja Universale Shëndetësore (PUMA) dhe nga Sigurimi Shëndetësor Plotësues Solidar (CSS).

Ju do të mund të përfitoni falas nga mbulimi i të gjitha shpenzimeve tuaja mjekësore dhe spitalore, si për veten tuaj, ashtu edhe për bashkëshortin/en dhe fëmijët tuaj. Mund t'ju duhet t'i paguani paraprakisht disa shpenzime, por ato do t'ju rimbursohen.

Ndihma Mjekësore Shtetërore (AME)

Personat pa leje pa dokumente.

AME-ja (Ndihma Mjekësore e Shtetit) ju jep të drejtën për mbulimin 100% të shpenzimeve mjekësore dhe spitalore, brenda kufijve të tarifave të përcaktuara nga sigurimet shoqërore. Nuk keni nevojë t'i paguani paraprakisht shpenzimet, përveç për disa barna të caktuara.

Kushtet për të përfituar nga AME-ja:

→ **Të mos keni leje qëndrimi dhe as vërtetim.**

→ **Të banoni në Francë prej më shumë se tre muajsh, në mënyrë të pandërprerë.**

→ **Të ardhurat tuaja nuk duhet të tejkalojnë një kufi të caktuar.**

APLIKIMI I PARË PËR AME

→ Shkarkoni formularin në ameli.fr ose merreni atë direkt në një pikë pritjeje CPAM.

→ Dorëzoni aplikimin tuaj për AME në një pikë pritjeje të CPAM.

→ **Nëse jeni një i mitur i pashoqëruar, ose nëse mund të lëvizni të udhëtoni për të dorëzuar aplikimin (lëvizshmëri e kufizuar)** mund ta dërgoni dosjen me postë, duke bashkëngjitur një dokument justifikues për situatën tuaj ose një deklaratë mbi nderin.

Për të shkuar në një pikë pritjeje të CPAM-it, duhet të caktoni një takim:

→ me telefon në 36 46

→ Në pikat e pritjes së CPAM (Fondi i Sigurimeve Shëndetësore) në Rhône

→ Përjashtimisht, në një strukturë shëndetësore ose në një PASS në spitalin ku po trajtoheni.

RINOVONI KARTËN TUAJ AME

Mund ta dorëzoni aplikimin tuaj personalisht në sportelin e pritjes ose ta dërgoni me postë:

FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE PARËSORE TË RHÔNE
69907 LION CEDEX 20

TË PËRGATISNI DOSJET PËR CSS-NË DHE AME-NË.

Mund të kërkoni ndihmë:

→ **Në pikën e pritjes së sigurimit shëndetësor (CPAM Rhône) me takim, nga llogaria juaj ameli ose në 3646.**

→ **Në departamentin e shërbimeve sociale të spitalit (faqja17) ose në Qendrën Komunale të Veprimit Social (CCAS) të qytetit tuaj**

→ **Pranë një shoqate (faqja 17) ose një qendër kujdesi ditor (faqja 15).**

CPAM ka 2 muaj kohë për të marrë vendimin e saj. Nëse aplikimi pranohet, mund të tërhiqni kartën tuaj CSS ose AME.
Ato zgjasin një vit nga data e paraqitjes së kërkesës. Kujdes, rinovimi nuk bëhet automatikisht; duhet ta ribëni dosjen dy muaj para skadimit të kartës.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

LLOGARI BANKARE

Ju mund të hapni **një llogari kursimi Livret A** pranë **La Banque Postale**. Është një llogari kursimi që ju lejon të depozitoni dhe të tërhiqni para në cash ose me transfertë bankare. Do të merrni një deklaratë llogarie bankare (RIB), e cila mund të kërkohet për procedurat administrative. Kushdo ka të drejtë të hapë një llogari bankare. Nëse po aplikoni për azil, SPADA ose shoqata e qendrës suaj të akomodimit mund të caktojë një takim për ju. Nëse hasni vështirësi, mund të kërkoni ndihmë nga një shoqatë (faqja7).

Për të hapur një llogari kursimi Livret A, duhet të:

- **jeni në moshë madhore (mbi 18 vjeç)**
- **Një dokument identiteti (vërtetimi i azilkërkuesit, pasaporta etj.).**
- **një vërtetim banim**
- **një shumë minimale prej 2 € duhet të depozitohet në llogari ditën e hapjes së saj.**

Karta e tërheqjes mund të përdoret vetëm me bankomatet e La Banque Postale.

QASJA NË PUNËSIM

Në Francë, për të pasur të drejtën për të punuar, është e detyrueshme të keni një leje qëndrimi OSE një vërtetim (récépissé) me autorizim pune.

Për azilkërkuesit

Nëse keni aplikuar për azil më shumë se 6 muaj më parë dhe OFPRA ende nuk ka marrë vendimin e saj, mund të aplikoni për leje pune. Është një procedurë e ndërlikuar dhe nuk funksionon gjithmonë, madje edhe me mbështetjen e punëdhënësit tuaj. Punëdhënësi juaj duhet të paraqesë një kërkesë për leje pune në faqen e internetit dhe duhet të sigurojë të gjitha dokumentet të kërkuara në:
https://administration-etrangers-en-france.interieur.gouv.fr/immiprousager
Në rast refuzimi: caktoni një takim në një klinikë ndihme ligjore (faqja 9).

Leja e punës është e vlefshme vetëm për:

- **Për punën që keni kërkuar. Nëse doni të ndryshoni punë, duhet të paraqisni një kërkesë të re për autorizim.**
- **Gjatë periudhës së vlefshmërisë së vërtetimit tuaj të kërkesës për azil(récépissé). Duhet të rinovoni autorizimin e punës sa herë që rinovohet vërtetimi juaj (récépissé), deri në marrjen e vendimit nga OFPRA.**
- **Në fund të kontratës suaj ose në rast të pushimit nga puna, ju keni të drejtë të regjistroheni në Pôle Emploi dhe të përfitoni nga trajnime profesionale.**

Për refugjatët

Nëse ju është dhënë azili (status refugjati, mbrojtje subsidiare ose status apatridi), mund të punoni në Francë pa asnjë kusht.
Në Lion, mund të përfitoni nga programi i integrimit Accelair.

Për të rinjtë

- **Misionet lokale :** Ndjekje e personalizuar dhe shoqërim profesional e social për të rinjtë nga 16 deri në 25 vjeç, të njohur si të mitur ose që kanë një leje qëndrimi nëse janë në moshë madhore.
- **Shërbimi civil :** Deri në moshën 26 vjeç, nëse keni të drejtë të punoni, mund të kryeni një shërbim civil për një periudhë prej 6 muajsh deri në 1 viti, me një pagesë prej 580 deri në 690 € në muaj.

Nuk keni autorizim pune

Nëse nuk keni dokumente qëndrimi ose nëse keni një leje qëndrimi pa autorizim pune, punëdhënësit nuk kanë – nga pikëpamja ligjore – të drejtë t'ju punësojnë.

Nëse punoni për një punëdhënës:

- **Ju nuk mund të ndiqeni penalisht për këtë arsye:** Janë punëdhënësit ata që mund të jenë, jo punëtorët.
- **Punëdhënësi juaj duhet të zbatojë kodin e punës!**
  Ju keni të njëjtat të drejta si çdo punonjës tjetër i punësuar rregullisht (Neni L8252-2 i Kodit Francez të Punës): e drejta për një kontratë pune (me afat të caktuar, të

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

përhershme, të përkohshme, CESU...), e drejta për pagesë për të gjitha orët e punuara, e drejta për fletëpagesa, e drejta për shëndet dhe siguri, e drejta për leje, e drejta për kompensim në fund të kontratës, etj.
Ju mund t'i mbroni këto të drejta përmes veprimit kolektiv (e drejta për grevë) dhe përmes veprimit gjyqësor (pranë Këshillit të Prud'hommes – gjykata e mosmarrëveshjeve të punës).

Kujdes: Nëse keni leje qëndrimi dhe merrni ndihmë shtetërore, duke punuar pa leje pune rrezikoni t'ju hiqen përfitimet ose t'ju kërkohet të rimbursoni ndihmën e marrë.

Këshillohet fuqimisht që të mos përdorni një kartë identiteti të rreme ose kartë identiteti të dikujt tjetër, pasi mund të përballeni me pasoja ligjore.

→ **Për të mësuar më shumë, kontaktoni një sindikatë në kompaninë ose qytetin tuaj (p.sh. CNT-SO, SUD, CNT, CGT, CFDT, FO...).**

Të drejtat sociale

Si punëtor, edhe nëse nuk keni dokumente, punëdhënësi juaj duhet t'ju deklarojë në URSSAF dhe të paguajë kontribute në organizatat sociale.

Por statusi juaj nuk ju lejon të merrni përfitime papunësie.
Gjithashtu ju privon nga përfitimi i pagesave ditore të sigurimeve shoqërore, përveç në një rast: nëse jeni viktimë e një aksidenti në punë.

Rregullimi i statusit të qëndrimit nëpërmjet punës.

Qarkorja "Retailleau" e vitit 2025 parashikon mundësinë që Prefekturat të japin, në mënyrë të jashtëzakonshme, leje qëndrimi nëpërmjet punës. Duhet të përmbushen disa kushte në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në Francë dhe kohëzgjatjen e punës:

→ Të paktën **7 vjet prani të vazhdueshme në Francë**

→ Të provoni **12 muaj punë të pandërprerë gjatë 24 muajve të fundit në një profesion me mungesë fuqie punëtore**

→ Të mos përbëni **kërcënim për rendin publik.**

→ **Zotërimi i frëngjishtes**

→ Të mos keni marrë **një OQTF të njoftuar brenda 3 viteve të fundit.**

→ Punëdhënësi **juaj** duhet të bëjë vetë një **"kërkesë për autorizim punësimi të një punonjësi të huaj".**

Lista zyrtare e profesioneve më të kërkuara sipas rajonit (2025):

https://www.legifrance.gouv.fr/jorf/id/JORFTEXT000051643488

Për më shumë informacion mbi procedurat që duhen ndjekur në prefekturën e Rhône:
https://www.demarches-simplifiees.fr/commencer/ aes-metiers-en-tension-rhone

Nëse mendoni se mund të jeni i/e kualifikuar, shkoni në një klinikë për ndihmë ligjore. (faqja 9) ose në një sindikatë (faqja 22).

SHKOLLË ÇERDHE

Nga shkolla fillore në shkollën e mesme

Në Francë, qasja në shkollë është një e drejtë për fëmijët nën 16 vjeç, pavarësisht nga statusi dhe lloji i akomodimit të prindërve. Shkolla është falas dhe ne nuk mund t'ua refuzojmë fëmijëve tuaj hyrjen.

Nga 3 deri në 10 vjeç, duhet të kontaktoni bashkinë e vendit tuaj të banimit ose të akomodimit për t'i regjistruar ata.

Nga mosha 11 deri në 16 vjeç, duhet të kontaktoni shkollën e mesme lokale në zonën tuaj të banimit ose të akomodimit për t'i regjistruar ata.

Përtej moshës 16 vjeç, duhet të kontaktoni QIK-un lokal (Qendra e Informacionit dhe Udhëzimit) në zonën tuaj të akomodimit ose të banimit.

Midis moshës 16 dhe 18 vjeç, trajnimi është një e drejtë dhe detyrim për të rinjtë që janë në rrezik të braktisin shkollën ose që nuk janë as të punësuar, as në arsim, as në trajnim.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Dokumentet e vetme të kërkuara janë:
→ Një dokument që vërteton identitetin
→ Një dokument që vërteton kujdestarët e fëmijës
→ Një dokument që vërteton vendbanimin
→ Nëse një nga këto dokumente nuk është i disponueshëm, një deklaratë mbi nderin është e mjaftueshme.

Në Lyon, shoqata CLASSES ndihmon familjet me procedurat e tyre administrative për shkollën:

C.L.A.S.S.E.S

06 80 71 32 96
contact@classes-asso.org

Të gjeni kujdes për fëmijët tuaj

Ju mund të shkoni në një Pikë Pritjeje dhe Informimi për Fëmijërinë e Hershme (PAIPE) për të marrë informacione mbi mënyrat e kujdesit për fëmijët tuaj. PAIPE-t japin informacione me telefon ose ju presin me takim të caktuar paraprakisht. Në çdo bashki ka një PAIPE.

Për më shumë informacion mbi programin PAIPE në Lyon, ju lutemi konsultohuni me këtë link:
https://www.lyon.fr/demarche/petite-enfance/les-points-accueil-information-petite-enfance-paipe

UNIVERSITETI

Të keni një certifikatë të gjuhës frënge

Ekzistojnë programe për mësimin e gjuhës frënge në universitete. Për më shumë informacion, shihni faqen e "Réseau MEnS":
https://reseau-mens.org/pour-etudiants
Disa shoqata ofrojnë edhe kurse frëngjishteje: shih faqen 23.

Të regjistroheni në universitet

Procedurat varen nga universiteti, programi i studimit, niveli i studimeve (Licencë, Master) dhe statusi juaj (azilkërkues, refugjat, pa dokumente etj.).
Viti shkollor është përgjithësisht nga shtatori deri në qershor.

Cilado qoftë situata juaj (pa dokumente, azilkërkues, refugjat/mbrojtje plotësuese/ pa shtetësi), ju mund të filloni ose të rifilloni studimet tuaja në Francë.
Për të aplikuar për regjistrim duhet të:

→ Të keni diplomën e maturës ose një diplomë universitare.
→ Të keni një certifikatë të gjuhës frënge (B2 për diplomën bachelor dhe C1 për diplomën master), përveç nëse vini nga një vend frankofon.

Regjistrimi në Universitetet e Lionit 1, 2 dhe 3:

→ **DU Passerelle i universiteteve Lion 2 dhe Lion 3 (mësimi i frëngjishtes universitare dhe rikthimi në studime):**aplikim i përbashkët në platformat e-Candidat të secilit universitet.

→ **Licenca e parë e përgjithshme (Licence 1):** të gjithë studentët e huaj në Francë, përveç atyre që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, duhet të paraqesin një dosje "DAP", pra Kërkesë për Pranim Paraprak.

→ **BTS, DUT:**aplikimet bëhen përmes platformës Parcoursup për të gjithë kandidatët.

Nëse përfitoni nga mbrojtja ndërkombëtare, drejtohuni pranë universitetit për të mësuar mënyrën e aplikimit (zakonisht nëpërmjet Kërkesave të Përshtatura për Pranim – Demandes d'Admission Adaptées).

→ **Licence 2 dhe 3 / Master 2:**regjistrohuni në faqen e internetit e-candidat. Nëse keni mbrojtje ndërkombëtare, procedura ndonjëherë është e ndryshme.

→ **Master 1** Aplikimet dorëzohen përmes faqes së internetit: monmaster.gouv.fr

Filloni me aplikimin tuaj për notat L2/L3/M1/ M2; disa aplikime bëhen që në mars/prill.

Tarifat e regjistrimit për studentët e huaj mund të jenë të larta: deri në 2 770 € për studimet e Licencës dhe 3 770 € për studimet Master. Mund të kontaktoni universitetin ose një shoqatë që mund t'ju ndihmojë të kërkoni heqjen dorë nga tarifat e regjistrimit.

→ Studentët që përfitojnë nga mbrojtja ndërkombëtare përjashtohen nga këto tarifa (ata paguajnë vetëm tarifat e zakonshme të regjistrimit, rreth 170 € për Licencën dhe 243 € për Masterin). Ata mund të aplikojnë për bursë dhe akomodim në një rezidencë universitare "CROUS".

Forma të tjera ndihme janë në dispozicion nëse jeni mbi 28 vjeç. Nëse keni vështirësi, shoqatat mund t'ju ndihmojnë (faqet 22-23).

Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). Bashkimi Evropian dhe EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

INFORMOHUNI NË INTERNET

Informacione mbi kërkesën për azil

Informacione të përkthyera mbi procedurën e kërkesë për azil, të verifikuara nga juristë. **Shkoni gjithmonë në një shërbim këshillimi juridik** për të vlerësuar situatën tuaj individuale (faqja 9).

WATIZAT INFO-EXIL

Informacione online mbi të drejtat sociale dhe procedurat administrative.
Gjuhët: anglisht, italisht, spanjisht, arabisht, tamilisht, somalisht, turqisht, pashto, dari, amarike, tigrinje, bengalisht.
https://watizat-info-exil.notion.site/

GISTI

Rubrika: Aplikimi për azil Gjuhët: Frëngjisht, Anglisht, Arabisht, Dari, Pashto, Urdu, Tigrinya, Oromo
http://www.gisti.org/spip.php?article5116

DOM'ASILE INFO

Gjuhët: frëngjisht, anglisht, arabisht, urduisht, bengalisht, rusisht. www.domasile.info

REFUGIES INFO

Informacion për personat që u është dhënë statusi i refugjatit ose mbrojtja plotësuese.
Gjuhët: frëngjisht, anglisht, arabisht, pashto, tigrinja, rusisht. https://www.refugies.info

INFORMACION MBI TË DREJTAT E TË HUAJVE

Informacione mbi procedurat e ndryshme të qëndrimit në Francë, bashkimin familjar, ribashkimin familjar, etj.
Gjuha: Vetëm frëngjisht
http://www.info-droits-etrangers.org/

INFOMIGRANTS

Informacion mbi azilin në Evropë.
Gjuhët: frëngjisht, anglisht, arabisht, dari, pashto www.infomigrants.net
Është e mundur të merrni artikujt e rinj nëpërmjet Rakuten Viber. Shkoni në fund të faqes së internetit për t'u regjistruar.

NUMRAT E URGJENCËS FALAS

15• SAMU

Shërbimi i Ndihmës Mjekësore Emergjente. Për të siguruar ndërhyrjen e një ekipi mjekësor në rast rreziku për jetën.

18 • ZJARRFIKËSIT

Sinjaloni një situatë të rrezikshme: aksident, zjarr, person të sëmurë...

17 • POLICIA

Merrni ndihmë në rast sulmi ose raportoni një vepër penale që kërkon ndërhyrje të menjëhershme të policisë.

114• URGJENCA ME SMS

U mundëson personave të shurdhër, me dëgjim të kufizuar dhe personave që nuk mund të telefonojnë (për shembull gratë viktima të dhunës), të njoftojnë shërbimet e emergjencës (SAMU, Zjarrfikësit, Xhandarmërinë dhe Policinë) 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, nëpërmjet SMS-it, bisedës online ose videokonferencës. Gjithashtu i aksesueshëm online në faqen www.urgence114.fr dhe përmes aplikacionit "114".

115• STREHIM URGJENT

Nr urgjence për personat që nuk kanë zgjidhje strehimi ose për viktimat e dhunës në familje që kanë nevojë për strehim dhe mbrojtje urgjente.

119•FËMIJË NË RREZIK

Nr urgjence i dedikuar për çdo fëmijë ose adoleshent viktimë e dhunës (psikologjike, fizike ose seksuale), si edhe për çdo person që është i shqetësuar për një situatë ku një fëmijë është në rrezik ose rrezikon të jetë i tillë, brenda familjes ose në një institucion.


3919•INFORMACION DHE DËGJIM PËR GRATË VIKTIMA TË DHUNËS

Ofron dëgjim, informacion dhe orientim për gratë viktima të dhunës, si edhe për dëshmitarët e dhunës ndaj grave. Nuk trajton situatat emergjente (nuk është një shërbim policie apo xhandarmërie).

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG


FJALOR

ADA: Ndihma për Azilkërkuesit
AME: Ndihma Mjekësore Shtetërore
APS: Leje e Përkohshme Qëndrimi
ASE: Ndihma Sociale për Fëmijët
CADA Qendra e Pritjes për Azilkërkuesit
CAF Arka e Ndihmave Familjare
CCAS Qendra Komunale e Veprimit Social
CMA Kushtet Materiale të Pritjes
CMAE Qendra e Strehimit të Përkohshëm dhe e Vlerësimit
CNDA Gjykata Kombëtare e të Drejtës së Azilit
CPAM Arka Parësore e Sigurimit Shëndetësor
CRA Qendra e Mbajtjes Administrative
CSS Sigurimi Shëndetësor Plotësues Solidar (më parë CMU)
DAHO E Drejta e Kundërshtueshme për Strehim **DALO** E Drejta e Kundërshtueshme për Banesë
DNA-ja Sistemi Kombëtar i Pritjes
FLE Frëngjishtja si gjuhë e huaj
GUDA Sporteli Unik për Azilkërkuesit
HUDA Strehimi Urgjent për Azilkërkuesit
IRTF Ndalimi i Kthimit në Territorin Francez
JLD Gjyqtari i Lirive dhe i Ndalimit
MDMS Shtëpia e Metropolit dhe Solidaritetit
MIE I Mitur i Huaj i Pashoqëruar
MNA I mitur i pashoqëruar
MVS Shtëpia e Mbikëqyrjes Sociale
OFII Zyra Franceze për Imigracionin dhe Integrimin
OFPRA Zyra Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Apatridëve
OQTF Detyrimi për t'u larguar nga territori francez
PAIPE Pikë Pritjeje dhe Informimi për Fëmijërinë e Hershme
Puma Mbrojtja Universale Shëndetësore
PRAHDA Programi i Pritjes dhe Strehimit të Azilkërkuesve
RSA Të Ardhurat Aktive të Solidaritetit
SIAO Shërbimi i Integruar i Pritjes dhe Orientimit
SPADA Struktura e Pritjes së Parë për Azilkërkuesit



WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

HARTA E METROSË DHE TRAMVAJIT TË LIONIT



T 7 Vaulx-en-Velin – La Soie Décines – OL Vallée
T 9 Vaulx-en-Velin – La Soie Charpennes
T 10 Halle Tony Garnier Gare de Vénissieux
Ouverture en 2027
T Gare Part-Dieu – Villette Aéroport Lyon Saint-Exupéry
T N190 N191 N192 Direction Décines – OL Vallée
Circulent uniquement lors de grands événements

[1] arrêt desservi seulement le mercredi, samedi, dimanche, jours fériés et vacances scolaires

Services

- Gare ferroviaire
- Parc Relais Auto TCL
- Parc Relais Vélo TCL
- Stationnement vélo sécurisé
- Toutes les stations de métro (sauf Croix-Paquet), funiculaire (Minimes : prendre la rame 1), tramway et trambus sont accessibles. Pour connaître la disponibilité des équipements, appeler le 04 26 10 12 12 ou consulter tcl.fr.

Calculez votre itinéraire ici

TCL Plan des lignes fortes

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

SHËNIME

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

Avec le soutien de

FONDATION AMNESTY INTERNATIONAL FRANCE
Sous l'égide de la FONDATION UNIVERSITÉ PARIS NANTERRE

GUIDE WATIZAT INFO-EXIL

ACCESSIBLE GRATUITEMENT EN LIGNE

WHAT IS THAT ?

Un nouveau **guide d'information socio-juridique** à destination des personnes exilées en France, **valable sur l'ensemble du territoire métropolitain.** Mis à jour selon l'actualité juridique et politique, et **traduit** en anglais, italien, espagnol, arabe, ourdou, tamoul, albanais, somali, turc, russe, pachto, dari, amharique, tigrigna, bengali.

POUR QUI ?

- Les personnes exilées en France
- Les mineurs non accompagnés
- Toute personne étrangère vivant en France
- Bénévoles et travailleurs sociaux
- Institutions et collectivités locales





Gjeni udhëzuesin Watizat Info-Exil falas në: 💻 https://watizat-info-exil.notion.site/

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG

TETOR / NËNTOR 2026
SHQIPTAR
Lyon

Nëse
ndodheni në Lyon
dhe jeni azilkërkues,
refugjat ose pa dokumente
qëndrimi, ky udhëzues është për ju.

Ai përmban **adresa të dobishme**,
këshilla dhe **procedura** juridike,
të përditësuara çdo dy muaj!

Tekstet tona janë hartuar, rilexuar dhe
verifikuar nga profesionistë të fushës sociale,
të azilit dhe të së drejtës së të huajve.

Ky udhëzues është i disponueshëm
në **Frëngjisht**, **Anglisht,**
Arabisht dhe **Shqiptar**.



Shkarkoni udhëzuesin:
www.watizat.org

A keni ndonjë pyetje?
Na kontaktoni:
lyon@watizat.org

Kontaktoni The Link për të biseduar me njerëz të vërtetë. Ju mund të:

- → **gjeni ndihmë në zonën tuaj lokale**
- → **merrni këshilla kudo në Francë**
- → **flisni në gjuhën tuaj**

Faleminder, konfidencial dhe anonim. Whatsapp, mesazhe me tekst dhe thirrje telefonike.

+33 7 57 59 90 12

www.thelink.ngo

Watizat lyon · watizatlyon · Watizat, chaine d'information · watizatasso

Nëse jeni një organizatë, shoqatë ose kolektiv, na kontaktoni për të porositur kopje të shtypura të udhëzuesve.

Ky udhëzues është falas dhe ndalohet shitja e tij për individët. Mos e hidhni në rrugë.

WATIZAT, TOUS DROITS RÉSERVÉS / WWW.WATIZAT.ORG